# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6068
E martë, 21 korrik 2020
çmimi 0.40 €


## ShBA-ja, thirrje BE-së: Liberalizoji vizat për Kosovën
FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


REPUBLIKA E KOSOVËS NUK DËSHIRON DIALOG TEKNIK ME SERBINË

# NUK KA DIALOG TEKNIK ME SERBINË




Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë shprehur kundër dialogut teknik me Serbinë në Bruksel. Ndonëse Bashkimi Evropian ka paralajmëruar për këtë javë një takim të tillë në Bruksel, liderët e institucioneve të Kosovës insistojnë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë vetëm për njohje reciproke. Presidenti Thaçi ka thënë se është me rëndësi jetike për Kosovën që në këtë proces të ketë një konsensus në mes të partive politike dhe institucioneve. Kurse kryeministri Hoti ka deklaruar se në takimin e kësaj jave në Bruksel do të diskutohet për draftimin e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë FAQE 4-5

KRYETARI I PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, LULZIM BASHA, PO QËNDRON PËR VIZITË DYDITORE NË KOSOVË

## BASHA OFRON PËRKRAHJEN E PD-së PËR PROCESET NËPËR TË CILAT PO KALON KOSOVA
FAQE 3

Lideri i opozitës së Shqipërisë, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ka shprehur mbështetjen e tij të plotë dhe të Partisë Demokratike për të gjitha qëndrimet e krerëve të institucioneve dhe politikës në Kosovë. Në vizitën e tij dyditore në Kosovë, ku ka takuar udhëheqësit e institucioneve të vendit dhe liderët e partive politike, Basha ka theksuar se pas zgjedhjes së tij kryeministër në zgjedhjet e ardhshme, vendimi i parë që do të ndërmarrë do të jetë heqja e taksës dhe traut në "Rrugën e Kombit"






## Katër të vdekur, 101 të shëruar dhe 142 raste të reja me Covid-19
FAQE 7

## OPINION

### UÇK-JA ISHTE USHTRI QË LUFTËN E BËRI PARA SYVE TË TË GJITHË BOTËS PËR T'IA DHËNË KOMBIT LIRINË (12)
F. 11

Shkruan: Kudusi LAMA



## AKTUALE



### EDHE PAS TRI DITËSH DISKUTIME, BE-ja ENDE PA MARRËVESHJE PËR PLANIN E RIMËKËMBJES
F. 2

### KËRKOHET QË SEANCAT GJYQËSORE TË MBAHEN PËRMES PLATFORMËS ONLINE
F. 6

## EKONOMI




### MINISTRIA E BUJQËSISË SHPALL THIRRJEN PËR APLIKIME PËR GRANTE DHE SUBVENCIONE
F. 8

### KONSTITUOHET KOMISIONI HETIMOR PËR PRIVATIZIM
F. 8

## SPORT

### STUDENTI I MJEKËSISË QË ASNJËHERË NUK E BRAKTISI LOJËN E FUTBOLLIT
F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Vaksina e Oksfordit kundër koronavirusit shkakton reagim imunitar

**Nju Jork, 20 korrik** - Një vaksinë kundër koronavirusit, e zhvilluar nga Universiteti i Oksfordit, duket se është e padëmshme dhe se e trajnon sistemin imunitar. Testimi i saj, i cili ka përfshirë rreth 1 077 njerëz, ka treguar se pas injektimit në trupat e tyre janë krijuar antitrupa dhe qeliza të bardha të gjakut që mund ta luftojnë koronavirusin. Gjetjet janë premtuese, por është ende herët të dihet nëse vaksina është e mjaftueshme për të ofruar mbrojtje. “Jemi vërtet të kënaqur me rezultatet e publikuara sot, sepse shohim edhe antitrupa, edhe qeliza T”, ka thënë për BBC-në profesori Andrew Pollard nga grupi i kërkimeve në Oksford.



# ShBA-ja, thirrje BE-së: Liberalizoji vizat për Kosovën

**Prishtinë, 20 korrik** - Komiteti për Punë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve në ShBA, i ka bërë thirrje Këshillit të Bashkimit Evropian, që ta përmbushë premtimin ndaj Kosovës, duke i siguruar liberalizimin e vizave. Komiteti, nëpërmjet një postimi në rrjetin social “Twitter”, ka rikujtuar se vendimi i Komisionit Evropian për Kosovën, ku thuhej se janë plotësuar kushtet për liberalizimin e vizave, është marrë dy vjet më parë.

Thirrjet drejtuar BE-së për t’i liberalizuar vizat për Kosovën janë shtuar nga Shtetet e Bashkuara. Më herët edhe i dërguari i posaçëm i Shtëpisë së Bardhë për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, i pati bërë thirrje BE-së t’i liberalizojë vizat për Kosovën.

Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian kishin konfirmuar se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret për liberalizim të vizave. Por, çështja ka ngecur në Këshillin e BE-së, ku disa shtete të rëndësishme nuk janë pajtuar që të liberalizohen vizat për Kosovën.

Edhe brenda institucioneve të BE-së është rritur presioni në drejtim të Këshillit të BE-së.



Dhjetëra eurodeputetë përmes një letre kanë kërkuar nga kancelarja gjermane Angela Merkel ta vendosë në agjendë të këshillit çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Më shumë se 40 deputetë të Parlamentit Evropian u kanë shkruar letra edhe presidentit të Francës, Emanuel Macron dhe kryeministrit të Holandës, Mark Rutte, përmes të cilave kërkojnë që BE-ja t’i liberalizojë vizat për Kosovën. Këta dy liderë të vendeve anëtare të BE-së, konsiderohen si kundërshtarët më të fuqishëm të liberalizimit të vizave për Kosovën, sepse vendet e tyre nuk e kanë mbështetur një vendim të tillë në Këshillin e BE-së.

Për ish-diplomatin gjerman Wolfgang Ischinger, çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën është një premtim i paplotësuar i BE-së. “Liberalizimi i vizave për të gjithë qytetarët e Kosovës është një premtim i paplotësuar i BE-së. Vonesë e gjatë. Besueshmëria e BE-së është në diskutim”, ka shkruar Ischinger në “Twitter”.

## Edhe pas tri ditësh diskutime, BE-ja ende pa marrëveshje për planin e rimëkëmbjes

**Bruksel, 20 korrik** - Drejtuesit e Bashkimit Evropian edhe të dielën kanë dështuar të arrijnë një marrëveshje mbi një paketë të rimëkëmbjes ekonomike. Negociatat pritet të vazhdojnë të hënën.

Samiti, i cili ka filluar më 17 korrik, ishte planifikuar të zgjasë dy ditë, por në mungesë të një marrëveshje-je, liderët e BE-së janë pajtuar t’i zgjasin bisedimet.

Kryesuesi i samitit, Charles Michel, u ka thënë 27 udhëheqësve të BE-së, se më shumë se 600 000 njerëz kanë vdekur si rezultat i koronavirusit në të gjithë botën dhe se ishte përgjegjësia e tyre të qëndrojnë së bashku në këtë kohë të krizës. “Shpresa ime është që ne të arrijmë një marrëveshje dhe që lajmi nesër të jetë se BE-ja e ka realizuar misionin”, ka thënë presidenti i Këshillit Evropian.

Në takimin e 18 korrikut, tensionet janë rritur kur kancelarja gjermane Angela Merkel dhe presidenti francez Emmanuel Macron u larguan nga mbledhja, së bashku me katër shtete të pasura, me qëllim që të gjenin kompromis mbi kufizimet që duhen vendosur për grantet dhe për kriteret ndaj shteteve që do të marrin grante për ta tejkaluar krizën ekonomike që është shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.

Çështja kryesore është se sa pjesë të fondit të rikuperimit do të shpërndahen si grante dhe sa si kredi.

Plani i rimëkëmbjes, i cili mbështetet nga Franca dhe Gjermania, aktualisht parasheh 500 miliardë euro grante dhe subvencione dhe 250 miliardë euro kredi.

Shtetet me më shumë kursime, si Austria, Suedia, Danimarka dhe Finlanda, duan kontroll mbi mënyrën e shpërndarjes së parave.

Shtetet e jugut, si Italia dhe Spanja, thonë se një gjë e tillë do ta bllokonte procesin.

Banka Qendrore Evropiane ka parashikuar tashmë rënie prej 8.7 përqindësh të ekonomisë së Eurozonës këtë vit për shkak të pandemisë së koronavirusit.



Udhëheqësit po përpiqen, gjithashtu, të përcaktojnë një buxhet të BE-së për vitet 2021-2027 në shumën 1 trilion euro.

EPOKA E RE
Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, po qëndron për vizitë dyditore në Kosovë

# Basha ofron përkrahjen e PD-së për proceset në të cilat po kalon Kosova

**Lideri i opozitës së Shqipërisë, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ka shprehur mbështetjen e tij të plotë dhe të Partisë Demokratike për të gjitha qëndrimet e krerëve të institucioneve dhe të politikës në Kosovë. Në vizitën e tij dyditore në Kosovë, ku ka takuar udhëheqësit e institucioneve të vendit dhe liderët e partive politike, Basha ka theksuar se pas zgjedhjes së tij kryeministër në zgjedhjet e ardhshme, vendimi i parë që do të ndërmarrë do të jetë heqja e taksës dhe traut në “Rrugën e Kombit”**



Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, po qëndron për vizitë dyditore në Kosovë. Ai të hënën është takuar me udhëheqësit e institucioneve të vendit dhe me liderët e partive politike.

Presidenti Hashim Thaçi me kryetarin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, ka diskutuar për zhvillimet në Kosovë e në Shqipëri dhe për mundësitë e bashkëpunimit më të mirë ndërshqiptar. Presidenti Thaçi ka theksuar se destinacioni i Kosovës është që sa më shpejt të bëhet pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian. “Çdo përvojë pozitive nga Shqipëria dhe përvojë personale në këtë proces, në veçanti për liberalizimin e vizave, është i rëndësishëm për ne si institucione të vendit”, ka thënë presidenti Thaçi.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar kryetarin Basha për kontributin e tij dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, por edhe për kontributin në procesin e konsolidimit të shtetit të Kosovës dhe atë të njohjeve ndërkombëtare dhe anëtarësimit të Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, ka shprehur mbështetjen e tij për presidentin Thaçi dhe për qëndrimet konsekuente në mbështetje të dialogut dhe në mbështetje të krijimit të unitetit në mes të të gjithë forcave politike në Kosovë. “Është pikëpamja ime dhe e Partisë Demokratike, se bashkërendimi midis të gjitha forcave politike të Kosovës dhe bashkëpunimi i tyre vetëm e forcon dhe e fuqizon Kosovën me sfidat me të cilat po përballet aktualisht”, ka thënë Basha, duke vijuar me tej se si parti e orientimit euroatlantik thekson bindjen dhe besimin se bashkërendimi i ngushtë midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian ka qenë dhe mbetet një parakusht për suksesin e çdo iniciative në raport me stabilizimin përfundimtar dhe perspektivën evropiane dhe euroatlantike të të gjitha vendeve të rajonit tonë. “Shpreh bindjen se një bashkërendim i tillë do ta fuqizojë dhe do ta përshpejtojë procesin e dialogut me synim - njohjen reciproke midis Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë”, ka thënë Basha.

Lideri i opozitës së Shqipërisë ka shprehur mbështetjen totale të tijën dhe të Partisë Demokratike për të gjitha qëndrimet e krerëve të institucioneve dhe politikës në Kosovë.

Basha është takuar edhe me kryeministrin Avdullah Hoti, me të cilin, pas takimit, ka mbajtur një konferencë për media. Me këtë rast, kryeministri Hoti ka thënë se ndihet i nderuar me praninë e Bashës sot, të cilin e ka quajtur “mik shumë i shtrenjtë”. “Unë sot isha i nderuar që bashkë me zëvendëskryeministrat dhe anëtarët e kabinetit ta presim kryetarin e opozitës dhe mikun tim shumë të shtrenjtë, z. Lulzim Basha. Ndamë me të shqetësimet tona edhe për menaxhimin e situatës me Covid, edhe për çështjet e rimëkëmbjes ekonomike, dy prioritetet tona kryesore si qeveri”, ka thënë kryeministri Hoti, i cili ka njoftuar se e ka informuar Bashën në hollësi për aktivitetet që po i bëjnë ekspertët shëndetësorë për menaxhimin e situatës me Covid.



Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, e ka falënderuar kryeministrin Hoti për ftesën dhe për bashkëbisedimin shumë të hapur, miqësor dhe vëllazëror. “Unë ndodhem gjithmonë me kënaqësinë shumë të madhe në Prishtinë që është, në fakt, edhe qyteti im i dytë pas Tiranës, jo vetëm për faktin se gjatë periudhës 2000-2004 kam jetuar këtu, ka qenë shtëpia ime, por edhe sepse e bëtë të tillë me vendimmarrjen tuaj për të më shpallur ‘Qytetar Nderi i Prishtinës’ para disa vitesh”, ka thënë kryetari i PD-së, Basha.

Ai e ka përgëzuar kryeministrin Hoti për lidershipin dhe rinisjen e dialogut me Serbinë në shinat dhe kornizën për të cilën ky dialog është konceptuar, duke shprehur mbështetjen tij të plotë dhe të Partisë Demokratike të Shqipërisë në këtë përqasje parimore që, siç ka thënë ai, ka dhe mund të ketë vetëm një përfundim: njohjen reciproke. Po ashtu, kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Lulzim Basha, ka ritheksuar se se pas zgjedhjes së tij kryeministër në zgjedhjet e ardhshme, vendimi i parë që do të ndërmarrë do të jetë heqja e taksës dhe traut në “Rrugën e Kombit”. “Ky është vendim i padrejtë që rëndon në ekonominë e Kosovës dhe Shqipërisë dhe ngadalëson shkëmbimin ekonomik dhe shanset për bashkërendim të faktorëve ekonomikë mes dy vendeve tona”, ka theksuar Basha.

Ndërkaq kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka kërkuar bashkërendim më të madh ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në shumë tema. Osmani, pas takimit me liderin e Partisë Demokratike në Shqipëri, Lulzim Basha, nëpërmjet një konference të përbashkët për media ka thënë se është e nevojshme që çdokush në Shqipëri të flasë kundër ideve për shkëmbim territoresh. “Është e domosdoshme që Kosova dhe Shqipëria t’i bashkërendojnë raportet ndërmjet dy vendeve, veçmas në ekonomi dhe politikë të jashtme. Është e nevojshme që çdokush në Shqipëri të flasë kundër ideve për shkëmbim territoresh”, ka thënë ajo.

Kurse lideri i PD-së, Lulzim Basha, ka thënë se dialogu me Serbinë duhet të jetë rruga për të ecur përpara, por me qëllimin e njohjes reciproke. Basha të hënën ka takuar përfaqësues të LV-së, të LDK-së, të AAK-së dhe të Nismës Socialdemokrate.

REPUBLIKA E KOSOVËS NUK DËSHIRON DIALOG TEKNIK ME SERBINË

# NUK KA DIALOG TE

Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Avdullah Hoti janë shprehur kundër dialogut teknik me Serbinë në Bruksel. Ndonëse Bashkimi Evropian ka paralajmëruar për këtë javë një takim të tillë në Bruksel, liderët e institucioneve të Kosovës insistojnë se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të jetë vetëm për njohje reciproke. Presidenti Thaçi ka thënë se është me rëndësi jetike për Kosovën që në këtë proces të ketë një konsensus në mes të partive politike dhe institucioneve. Kurse kryeministri Hoti ka deklaruar se në takimin e kësaj jave në Bruksel do të diskutohet për draftimin e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë




EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 20 korrik** - Liderët e institucioneve të Kosovës janë shprehur kundër vazhdimit të dialogut teknik me Serbinë në Bruksel. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shprehur kundër bisedimeve teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke thënë se bisedimet në një format të tillë janë zhvilluar gjatë nëntë viteve të kaluara.

Ndonëse BE-ja ka paralajmëruar për këtë javë një raund të dialogut teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë, kryeministri Avdullah Hoti ka deklaruar se ky proces do të jetë politik dhe në shërbim të draftimit të marrëveshjes finale Kosovë - Serbi.

Presidenti Thaçi ka deklaruar se është me rëndësi jetike që Kosova ta ketë një konsensus nacional për këtë fazë të dialogut. "Është me rëndësi jetike të kemi koordinim, e para mes spektrit politik të Kosovës, një konsensus sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që të jetë angazhim i unitetit të qytetarëve, shoqërisë civile, politikës, partive dhe institucioneve. Gjithashtu, është jetike për ne që edhe faktori ndërkombëtar të jetë i koordinuar. Një koordinim i ngushtë në mes të Uashingtonit dhe Brukselit në mënyrë që të jetë një proces i sigurt, i besueshëm, pastaj i pranueshëm për qytetarët e Kosovës", ka thënë Thaçi pas takimit me kryetarin e Partisë Demokratike në Shqipëri, Lulzim Basha.

Shefi i shtetit ka thënë se Kosova më nuk mund të diskutojë për çështje teknike me Serbinë. "Procesi duhet të përmbyllet jo në aspektin teknik, sepse aspektin teknik e kemi diskutuar tash e nëntë vjet, por duhet të përmbyllet me njohje reciproke sa më shpejt që është e mundur", është shprehur Thaçi.

Edhe kryeministri Avdullah Hoti ka deklaruar se dialogu me Serbinë është vetëm politik për njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve. Ai ka bërë me dije se është paraparë një takim për këtë javë në Bruksel, me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, duke shtuar se aty do të diskutohet për draftimin e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Të enjten është një takim tjetër në Bruksel. Aty do të jetë i pranishëm koordinatori shtetëror për dialog të cilin do ta emëroj së shpejti, për të biseduar dhe për ta draftuar marrëveshjen finale për njohje reciproke. Ky është objektivi ynë i vetëm në këtë proces", ka deklaruar Hoti.

Përkundër faktit se edhe Bashkimi Evropian ka deklaruar se ky është takim i nivelit teknik, Hoti ka përjashtuar çdo mundësi që të ketë rinisje të procesit teknik të dialogut me Serbinë. "Ky është objektivi ynë i vetëm në këtë proces. Çdo koment tjetër që dëgjoni, unë besoj që ose nuk janë të informuar plotësisht, ose dëshirojnë vetë t'i shtrembërojnë gjërat ashtu si dëshirojnë ata. Sot unë kam dërguar ftesat për takimin e nesërm për forumin e liderëve të partive politike. Gjithashtu, kam dërguar shkresë në Kuvendin e Kosovës për ta informuar Kuvendin për Samitin e Parisit dhe për të gjitha zhvillimet deri më tash në proces të dialogut. Ashtu siç e kam thënë prej ditës së parë, do të jem plotësisht transparent në këtë proces. Por, dialog teknik nuk ka. Ka vetëm dialog politik për njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve", ka thënë Hoti.

Ai ka vlerësuar se është etabluar pozicioni i Republikës së Kosovës në këtë proces dhe është mirëkuptuar plotësisht nga partnerët ndërkombëtarë.

## Hoti takon Tërnavën: Harmonia ndërfetare, vlerë e veçantë e popullit të Kosovës

**Prishtinë, 20 korrik (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnava, me të cilin ka biseduar për gjendjen aktuale në vend si dhe për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, sidomos për përpjekjet e menaxhimit të pandemisë Covid 19 dhe për pakon e rimëkëmbjes ekonomike.

Në këtë takim, po ashtu, është biseduar edhe për proceset e tjera të rëndësishme nëpër të cilat po kalon vendi, duke përfshirë edhe dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, që duhet të përfundojë me njohjen reciproke në mes të dy vendeve.

Hoti e ka falënderuar Tërnavën dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për rolin e kësaj bashkësie dhe të bashkësive të tjera fetare, duke theksuar se bashkëjetesa dhe harmonia ndërmjet besimeve të ndryshme ka qenë përherë një vlerë e veçantë e popullit të Kosovës.



# KNIK ME SERBINË




"Kemi filluar me Samitin e Parisit dhe me videokonferencën të dielën e javës që shkoi, mandej takimin e fundit në Bruksel të enjten, për dy tema specifike, duke ditur gjithmonë se cili është synimi final i procesit të dialogut që është vetëm njohja reciproke dhe normalizimi i marrëdhënieve. Normalizimi i marrëdhënieve është derivat i njohjes reciproke. Çdo zgjidhje që ne e bëjmë në marrëveshjen finale për normalizim të marrëdhënieve duhet të jetë derivat i njohjes reciproke. Pra, si dy vende të pavarura se si i adresojnë çështjet që i kanë mes vete", është shprehur ai.

Shefi i ekzekutivit ka njoftuar se ka dërguar ftesa për një takim të liderëve të partive politike në Kosovë. Në takimin që pritet të mbahet këtë javë në Bruksel, është thënë se do të bisedohet për dy tema kryesore: për të pagjeturit si dhe për çështje të ekonomisë.

Pas 20 muajsh, dialogu Kosovë - Serbi ka rifilluar më 16 korrik në Bruksel, mes kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit serb, Aleksandër Vuçiq. Dy temat kryesore në këtë takim ishin personat e pagjetur dhe bashkëpunimi ekonomik. Pas këtij takimi, Brukseli ka paralajmëruar se dialogu në nivelin teknik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të rinisë këtë javë.

### Opozita kritikon dialogun e Brukselit

Dy subjektet politike opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës, e kanë kritikuar qeverinë Hoti për vazhdimin e dialogut të Brukselit. Sipas këtyre dy partive politike, qeveria Hoti nuk ka legjitimitet dhe as platformë për ta vazhduar këtë proces.

Anëtari i kryesisë i PDK-së, deputeti Enver Hoxhaj, e ka konsideruar të nxituar, pa qartësi dhe pa mbështetje të nevojshme politike dhe institucionale takimin e kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, në Bruksel, me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk është e përgatitur politikisht dhe përmbajtësisht për dialogun. "PDK-ja nuk është kundër dialogut, por është seriozisht kundër qasjes dhe mënyrës së gabuar se si Qeveria e Kosovës po i qaset dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Takimi para dy ditësh në Bruksel tregoi se Qeveria e Kosovës nuk është e përgatitur politikisht dhe përmbajtësisht për dialogun dhe ajo hyri në një proces të tillë: pa platformë, pa strategji, pa konsensus, pa koordinim, pa përvojë për këtë proces dhe, pa asnjë ekspert", ka thënë Hoxhaj.

Kurse deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, ka thënë se takimi i kryeministrit Avdullah Hoti me presidentin serb Aleksandër Vuçiq nuk ka qenë produktiv. "Dialogu po zhvillohet pa platformë. Nga gjithë takimi i djeshëm doli në pah vetëm që Hoti flet gjuhën serbe. Zotëri Hoti nuk ka kredibilitet dhe legjitimitet për ta përfaqësuar Kosovën", ka thënë Abrashi.

Edhe njohësit e rrethanave politike në vend e kanë kritikuar qasjen e qeverisë Hoti ndaj procesit të dialogut në Bruksel. Ata kanë vlerësuar se pozicioni i Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë është dobësuar pas publikimit të aktakuzës nga Gjykata Speciale për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. Ndërsa këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) i ka kërkuar qeverisë që t'i pezullojë bisedimet me Serbinë.

## Hoti të premten raporton në Kuvend për rifillimin e dialogut

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, i është përgjigjur pozitivisht kërkesës për raportim të kryeministrit Avdullah Hoti për rifillimin e dialogut Kosovë - Serbi. Ajo ka thënë se pas diskutimeve me kryesinë kanë vendosur që të premten në orën 12:00, shefi i ekzekutivit të raportojë te të zgjedhurit e popullit. "Tani presim përgjigjen nga ana e kryeministrit rreth kohës së propozuar", ka deklaruar Osmani gjatë konferencës së përbashkët për media me kryetarin e PD-së, Lulzim Basha.

Javën e kaluar Hoti ka takuar presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me ndërmjetësimin e zyrtarëve të lartë evropianë.

## MSh-ja apelon që qytetarët të mos bien pre e "recetave" të rreme kundër Covid-19

**PRISHTINË, 20 KORRIK (ER)** - Ministria e Shëndetësisë e Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos bien pre e publikimeve ku po prezantohen "receta" të ndryshme për trajtimin e personave me Covid-19, sëmundjen që e shkakton koronavirusi.

Gjatë ditës së diel në rrjetet sociale janë shpërndarë "receta" të ndryshme lidhur me trajtimin mjekësor në shtëpi kundër Covid-19. "Duke qenë që 'recetat' e tilla provokojnë edhe reagime të ndryshme dhe ngjallin edhe shqetësime, ju lusim që të mos bini pre e publikimeve të tilla dhe për çfarëdo shqetësimi lidhur me Covid-19 ta kontaktoni mjekun tuaj më të afërt dhe t'i përcillni vetëm këshillat zyrtare të cilat publikohen nga Ministria e Shëndetësisë, IKShPK, profesionistët kompetentë shëndetësorë dhe institucionet kredibile dhe të konfirmuara", thuhet në reagimin e MSh-së.

Aktualisht në botë nuk është zbuluar ende një vaksinë kundër koronavirusit të ri, ndonëse përpjekje për një gjë të tillë po bëjnë shumë shtete dhe kompani në mbarë botën.



# Kërkohet që seancat gjyqësore të mbahen nëpërmjet platformës online

**Nën masat e mbrojtjes nga pandemia Covid-19 dhe nëpërmjet video-konferencës, është mbajtur të hënën takimi i asamblesë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës nën udhëheqjen e kryesuesit, Bashkim Hyseni, kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj**



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 KORRIK - Nën masat e mbrojtjes nga pandemia Covid-19 dhe nëpërmjet video-konferencës, është mbajtur të hënën takimi i asamblesë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës nën udhëheqjen e kryesuesit, Bashkim Hyseni, kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj. Kryesuesi i asamblesë, Bashkim Hyseni, takimin e ka filluar me një minutë heshtje në shenjë respekti dhe nderimi me rastin e vdekjes së gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Shashivar Hoti dhe prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Ismet Ukshini.

Takimi ka vazhduar me diskutimin e pikave sipas rendit të ditës: Diskutim mbi trajnimet e obligueshme për gjyqtarë; Çështja e ekzekutimit të dënimeve të kundërvajtjeve; Lëndët e shënjestruara; Rrezikimi i parashkrimit të lëndëve për shkak të pandemisë; Lëndët për pagat jubilare dhe shujtat e punëtorëve të arsimit; Rekomandimi i Komisionit për Administrimin e Gjykatave për vendim lidhur me shtyrjen e seancave etj.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, Skender Çoçaj, para se të diskutohen pikat e rendit të ditës, ka folur rreth situatës së menaxhimit të gjykatave gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, duke e cilësuar serioze dhe me vështirësi të shumta për punën në sistemin gjyqësor. Çoçaj ka kërkuar nga kryetarët e gjykatave që të zbatohet plani emergjent për menaxhimin e krizave dhe të bëhet dezinfektimi në të gjitha gjykatat si masë parandaluese e përhapjes së pandemisë Covid-19. "Është shumë e rëndësishme t'i zbatojmë masat sepse pasojat janë të mëdha, situata më e vështirë është në pallatin e drejtësisë por, përkundër vështirësive dhe punës me staf të reduktuar, të gjitha gjykatat po trajtojnë rastet që janë me prioritet, si ato të paraburgimit, dhunës në familje etj", ka thënë kryesuesi Çoçaj.

Rreth pikës mbi trajnimet e obligueshme për gjyqtarë, sipas diskutimeve, Akademia e Drejtësisë është duke vazhduar mbajtjen e trajnimeve online, përkundër situatës së krijuar nga pandemia. Sipas asamblesë së kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, vijueshmëria e trajnimeve të gjyqtarëve është e obliguar dhe mosvijueshmëria është shkelje disiplinore. Andaj është kërkuar vijueshmëri e obliguar për shkak të plotësimit të kuotës në vijueshmërinë e trajnimeve nga gjykatat që vijnë.

Si pikë tjetër u diskutua çështja e ekzekutimit të dënimeve të kundërvajtjeve ku, sipas kryesuesit të asamblesë, Hyseni, ky ligj ka krijuar konfuzitet dhe mospërmbarimi i gjobave kundërvajtësve për shkak të dy neneve kundërthënëse në Ligjin për Kundërvajtje po sjellë probleme në ekzekutimin e këtyre lëndëve. "Duke pasur parasysh se të gjitha gjykatat po ballafaqohen me këtë vështirësi dhe se mënyra e ekzekutimit po sjell pengesa, kërkoj që për shkak të situatës të gjejmë një zgjidhje alternative, përfshirë këtu edhe JSSP", ka thënë Hyseni.

Asamblistët vendosën që të formohet një grup punues me profesionistë të Gjykatës Supreme, gjykatave të tjera dhe së bashku me JSSP të përgatisin një opinion ligjor me qëllim të gjetjes së një zgjidhje.

Rëndësi të veçantë në këtë takim zuri diskutimi rreth lëndëve të shënjestruara. Sipas kryesuesit Çoçaj, për shkak të rëndësisë së madhe që kanë këto lëndë, edhe pse puna është e vështirësuar, këto lëndë duhet të vazhdohen, të gjitha rastet ku nuk mund mbahen gjykime, të gjenden objekte të tjera ku mund të mbahen gjykimet, duke i zbatuar edhe masat kufizuese Covid-19.

Ndërsa kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka kërkuar nga gjyqtarët që janë të ngarkuar me lëndët e shënjestruara, që t'i fusin në databazë dhe të përditësohen të gjitha veprimet procedurale.

Gjithashtu, parashkrimi i lëndëve për shkak të pandemisë ishte një ndër pikat e diskutimit në asamble megjithatë, edhe përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia për funksionimin e gjykatave, lëndët e tilla duhet të trajtohen dhe të jenë në agjendën prioritare të gjykatave.

Sa i përket pikës lidhur me lëndët për pagat jubliare dhe shujtat e punëtorëve të arsimit, asamblistët shfaqen shqetësimin e tyre për rritjen enorme të këtyre lëndëve dhe u diskutua mundësia e komunikimit me institucione të tjera si MASh, MPL, Asociacionin e Komunave të Kosovës, në funksion të mundësisë së zgjidhjes së grumbullimit të lëndëve të kësaj kategorie në gjykata.

Hyseni dhe Çoçaj kanë kërkuar nga kryetarët e gjykatave që t'i marrin parasysh rekomandimet e Komisionit për Administrimin e Gjykatave (KAGj) drejtuar KGjK lidhur me shtyrjen e seancave me qëllim që këto rekomandime do të ndihmojnë që të minimizohen seancat joproduktive, zvarritja e proceseve gjyqësore, njëkohësisht do të garantohet rritja e efikasitetit të gjykatave.

Në fund të këtij takimi, kryetari Hyseni ka kërkuar nga kryetarët e gjykatave që në rrethanat e pandemisë të fillojnë platformën online edhe në procedurat civile.

# 'Ec ma ndryshe' realizon performancën për një shfrytëzim të sigurt të hapësirave publike




PRIZREN, 20 KORRIK (ER) - Organizata "Ec ma ndryshe" ka realizuar performancën publike "Për një shfrytëzim të sigurt të hapësirave publike…" e cila ka adresuar rëndësinë e kujdesit të qytetarëve gjatë shfrytëzimit të hapësirave publike si pasojë e pandemisë Covid-19.

Gjatë kësaj performance është bërë shpërndarja e mesazheve senziblizuese lidhur me kujdesin që qytetarët duhet ta ndërmarrin gjatë shfrytëzimit të hapësirave të përbashkëta, me qëllim të zvogëlimit të mundësisë së përhapjes së këtij virusi te shfrytëzuesit e tjerë potencialë.

Po ashtu, është bërë vendosja e porosive për distancim social në parqet e qytetit të Prizrenit dhe mobiliarit urban përkatës.

Porositë sensibilizuese kanë bërë thirrje për përdorim të maskave, kujdes të higjienës personale dhe distancim të mjaftueshëm social në rrugë, sheshe, parqe dhe hapësira të tjera publike, ku frekuentimi i qytetarëve është vërejtur të jetë dukshëm më i koncentruar pas thirrjes së autoriteteve shtetërore për evitimin e hapësirave të mbyllura.

EC ka parë me shqetësim se si në këto hapësira, të cilat u shërbejnë të gjithëve pa dallim, jo gjithmonë respektohen masat e paracaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Performanca publike "Për një shfrytëzim të sigurt të hapësirave publike…" është organizuar në kuadër të aleancës për "Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë" e cila përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center e që mbështetet nga Qeveria e Suedisë.

# Katër të vdekur, 101 të shëruar dhe 142 raste të reja me Covid-19

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit në Kosovë janë shëruar 101 persona të infektuar me Covid-19, katër persona kanë vdekur dhe janë paraqitur 142 raste të reja të infektimeve. Pas publikimit të këtyre statistikave, IKShPK-ja ka treguar se numri i përgjithshëm i rasteve pozitive me Covid-19 në Kosovë ka shkuar në 5 877, prej tyre 3 069 persona janë shëruar, 139 kanë vdekur dhe 2 669 janë raste aktive

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 20 korrik - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 142 raste të reja me Covid-19 në vendin tonë si dhe kanë ndërruar jetë katër persona. Po ky institut ka njoftuar se nga Covid-19 janë shëruar edhe 101 persona, duke e çuar në 3 069 numrin e përgjithshëm të të shëruarve. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 485 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 142 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 5 877 raste, nga 31 541 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 139 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 101 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 3 069 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 669", ka njoftuar IKShPK, duke shtuar se Prishtina dhe Ferizaj prijnë me numrin më të madh të rasteve pozitive me Covid-19. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 47 raste, komuna Gjilan 13 raste, komuna Mitrovicë 12 raste, komuna Gjakovë 9 raste, komuna Vushtrri 9 raste, komuna Drenas 7 raste, komuna Podujevë 6 raste, komuna Fushë-Kosovë 5 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Pejë 3 raste, komuna Prizren 3 raste, komuna Skenderaj 3 raste, komuna Rahovec 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Dragash 2 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Deçan, Klinë, Malishevë, Shtime dhe Zveçan.", ka njoftuar IKShPK-ja.

Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin drejtuar qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë, virusi është kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virusi vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. "Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka njoftuar ky institut.

Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. "Nuk ka të drejtë askush ta rrezikojë jetën e të afërmve të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe moszbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm. Ju lutem të keni kujdes, sepse ende ekziston rreziku i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve. Ne po punojmë për ju, andaj na ndihmoni pak që t'ju ndihmojmë shumë", ka njoftuar IKShPK-ja.




# ShSKUK-ja: Furnizimi me masa mbrojtëse për punëtorët është i mirë

Prishtinë, 20 korrik (ER) - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se, pavarësisht prej rritjes së numrit të rasteve që po trajtohen me Covid-19, edhe rritjes së kërkesave nga klinikat dhe spitalet e përgjithshme, furnizimi me material shpenzues dhe masa mbrojtëse për stafin shëndetësor, përfshirë edhe dorezat, është i mirë. "ShSKUK në bashkëpunim me Departamentin Farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë së fundmi është furnizuar me sasi shtesë të masave mbrojtëse, të cilat përmes Shërbimit Farmaceutik në ShSKUK janë shpërndarë për klinikat që po trajtojnë rastet me Covid, por edhe spitalet e përgjithshme. Po ashtu, ShSKUK është e furnizuar me barnat themelore që nevojiten për trajtim të rasteve me Covid-19", është thënë në njoftimin e këtij shërbimi.

ShSKUK-ja ka treguar se në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë do të vazhdojë t'i furnizojë me masa mbrojtëse klinikat dhe spitalet e përgjithshme. "ShSKUK falënderon të gjithë mjekët, infermierët dhe punëtorët e tjerë mbështetës që, përkundër mbingarkesës së madhe, janë duke ofruar shërbime shëndetësore për pacientët e dyshuar dhe të konfirmuar me Covid-19", është thënë në njoftimin e ShSKUK-së.



# Konstituohet Komisioni Hetimor për Privatizim



Në Kuvendin e Kosovës është konsistuar komisioni hetimor lidhur me privatizimin në Kosovë. Ky komision do të kryesohet nga deputeti Hajrullah Çeku dhe do të përbëhet nga 11 anëtarë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 QERSHOR - Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë ka mbajtur të hënën mbledhjen e parë, në të cilën është diskutuar për planin e veprimit të këtij komisioni. Ky komision do të kryesohet nga deputeti Hajrullah Çeku dhe do të përbëhet nga 11 anëtarë. Anëtarët fillimisht nuk janë pajtuar në disa pika të draftit, në të cilat kanë theksuar se më shumë ka komente dhe konstatime sesa pyetje që mund ta nxjerrin të vërtetën në shesh.
Anëtari i këtij komisioni nga radhët e PDK-së, Sejdi Hoxha, ka thënë se nuk duhet që të ketë konstatime në planin e punës së komisionit. "E pashë shkurtimisht planin e veprimit. E lexova në mënyrë të shpejtë, por kam disa vërejtje. Në disa pika pashë se shkruan: 'Disa parti për dy dekada kanë qenë të përfshira në këtë proces'. Që i bie se për dy dekada ka qenë PDK-ja, e cila është vetë iniciuesja e këtij komisioni. Pra, nuk dua që ky komision që në fillim të politizohet. Unë nuk pajtohem që ta inkuadrojmë këtë koment në këtë planprogram. Nuk duhet të ketë konstatime", u shpreh Hoxha.
Ai ka thënë se AKP-ja i ka me emër e mbiemër se kush ka përfituar nga privatizimi në Kosovë. "Kërkesa ime është që mos të fshihet asgjë. Pa dashur të politizohet. Në pyetjen se kush ka privatizuar dhe kush ka përfituar në Kosovë nga privatizimi, mendoj se këtë mund ta bëjë AKP-ja. Me emër e mbiemër i ka AKP-ja se kush i ka privatizuar për krejt vitet. Në pyetjen tjetër se sa para janë nxjerrë nga privatizimet, mendoj se janë të gjitha transferimet bankare", është shprehur ai.
Kurse deputetja Doruntinë Maloku nga LDK-ja ka kërkuar që ky draft mos të ketë konstatime, por të jetë më shumë si udhëzues, në mënyrë që e vërteta e privatizimeve të zbardhet.
E anëtari tjetër nga radhët e PDK-së, deputeti Gazmend Bytyçi, ka thënë se është krijuar bindja se nga privatizimi më së shumti kanë përfituar komandantët e UÇK-së. "Është një lloj bindje se nga privatizimet kanë përfituar më shumë komandantët e luftës së UÇK-së e anëtarët e PDK-së. Po e nisim me fabrikat në Ferizaj, ku shumë fabrika atje janë privatizuar dhe asnjëra prej tyre nuk është privatizuar nga komandantët e UÇK-së apo anëtarë të PDK-së", është shprehur Bytyqi.
Liburn Aliu, deputet nga Lëvizja Vetëvendosje, ka marrë shembull privatizimet e tokave e më pastaj shpronësimin e tyre. Ai ka thënë se ka raste kur një tokë është privatizuar për pesë euro e që është shpronësuar për 5 000 euro. Kurse deputeti i AAK-së, Bekë Berisha, ka kërkuar që ky komision mos të politizohet. "Po i them Liburnit, që mos të mendojë se PDK-ja ka iniciuar këtë proces nëse nuk kanë gjetur keqpërdorime edhe për juve", është shprehur Berisha.
Anëtarët e këtij komisioni kanë kërkuar që në seancën e Kuvendit të votohet buxheti për këtë komision. Gjithashtu, është theksuar që AKP-së t'i kërkohet i gjithë procesi i privatizimit për të gjitha këto vite.

# Sektori i gastronomisë pret përkrahjen e shtetit



PRISHTINË, 20 KORRIK - Subvencionimi i pagave, i qirave dhe riprogramimi i kredive janë disa prej kërkesave që gastronomët e Kosovës kërkojnë nga qeveria për mbështetjen e tyre gjatë pandemisë Covid-19.
Petrit Kllokoqi nga Shoqata e Gastronomëve e Kosovës, në një konferencë për media, ka deklaruar se reflektimi i shtetit ndaj këtij sektori në këtë kohë të pandemisë është shumë i zbehtë. "Ne e kemi organizuar këtë mbledhje për Qeverinë e Kosovës që të jenë bashkëpunues. Gastronomët janë të parët që u mbyllën dhe të fundit që u hapën. Reflektimi i shtetit ndaj neve është shumë i zbehtë dhe për këtë e kemi organizuar një mbledhje që t'i propozojmë qeverisë një bashkëpunim", ka thënë Kllokoqi.
Ai ka thënë se ky sektor është duke funksionuar me vetëm 10 për qind të qarkullimit. "Gastronomia është duke e vuajtur këtë pandemi. Mund të themi se jemi në një sëmundje ekonomike, ku jemi të prekur të gjithë. Jemi duke punuar me 50 për qind më pak. Distancën që kemi krijuar jashtë, na ka humbur edhe 20 për qind të qarkullimit, plus edhe shkurtimi i orarit na ka reduktuar për 20 për qind, ku ne jemi duke funksionuar me 10 deri 15 për qind të qarkullimit, ndërsa shpenzimet i kemi të pranishme të gjitha. Të hyrat tona janë të vogla dhe jemi në prag të falimentimit", ka shprehur mendimin Kllokoqi.
Kllokoqi ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të mbështetet financiarisht ky sektor. "Po kërkojmë lehtësim financiar. Ne sot jemi mbledhur për ta kërkuar subvencionimin e pagave. Na kanë dhënë vetëm nga 170 euro lëmosh e më nuk kanë vazhduar. Po kërkojmë subvencionim të qirave për 50 për qind, po kërkojmë riprogramim të kredive, po kërkojmë shtyrje të deklarimit të tatimeve për së paku tre muaj. ATK-ja është duke shtuar presionin ndaj nesh. Të hyrat tona kanë rënë", është shprehur Kllokoqi. Sipas tij, duhet të riprogramohet Manuali i Ministrisë së Shëndetësisë që e prek këtë sektor. "Po ashtu, kërkesë tjetër është edhe riprogramimi i manualit. Duhet të ulemi së bashku dhe ta rishikojmë. Ne mendojmë se riprogramimi duhet të bëhet në bazë të metrave katrorë", është shprehur ai.

# Ministria e Bujqësisë shpall thirrjen për aplikime për grante dhe subvencione

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar se ka hapur thirrjen për aplikime për grante dhe subvencione për periudhën 2020/2021. Sipas ministrit të Bujqësisë, Besian Mustafa, shuma e tërësishme e programeve do të jetë 53 milionë euro




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 KORRIK - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar se ka hapur thirrjen për aplikime për grante dhe subvencione për periudhën 2020/2021. Sipas ministrit të Bujqësisë, Besian Mustafa, shuma e tërësishme e programeve do të jetë 53 milionë euro. "Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sot ka hapur thirrjen për aplikime për fermerët, agropërpunuesit dhe bizneset rurale për disa nga masat e zhvillimit rural për vitin 2020/2021 dhe për të gjitha masat e Programit për Pagesa Direkte për vitin 2020, me një buxhet gjithsej prej 53 milionë eurosh", ka thënë Mustafa, duke bërë me dije se aplikuesit do të përfitojnë 50 për qind paradhënie.

Këto dy programe kanë për qëllim mbështetjen e aftësisë konkurruese të sektorit agro-rural, rritjen e prodhimit dhe të produktivitetit në bujqësi, përmirësimin e sigurisë së ushqimit, përdorimin e teknologjisë moderne, diversifikimin e aktiviteteve në ferma dhe biznese rurale, mbrojtjen e mjedisit dhe të resurseve natyrore, krijimin e vendeve të punës dhe përmirësimin e bilancit tregtar të produkteve bujqësore dhe ushqimore. "Me qëllim të rritjes së transparencës dhe menaxhimit më të mirë të zbatimit të këtyre dy programeve, si dhe duke marrë parasysh situatën aktuale me pandeminë Covid-19 e cila e ka vështirësuar situatën ekonomike të fermerëve dhe bizneseve agro-rurale, kemi ndërmarrë disa hapa që ta lehtësojmë procesin e aplikimit", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë.

Sipas kësaj ministrie, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe duke përfituar nga përvojat e tyre globale, është zhvilluar aplikimi tërësisht online për grante, gjë që janë rritur transparenca dhe barazia në miratim të aplikacioneve. Kjo përmirëson menaxhimin e granteve dhe ndihmon menaxhimin e pandemisë Covid-19. "Të gjithë përfituesit e të gjitha granteve për periudhën 2020-2021 do të përfitojnë 50 për qind paradhënie, me garanci bankare, duke rritur kështu likuiditetin dhe mundësinë për të investuar në biznese agro-rurale. Për t'ju përshtatur kalendarit sezonal në bujqësi, Programi i Zhvillimit Rural 2020-21 do të ketë më shumë se një thirrje, duke filluar sot me këta sektorë: MASA 101: investimet në pasuritë fizike në ekonomitë bujqësore - sektori i prodhimit të pemëve drufrutore dhe pemëve arrore si dhe serrave; MASA 103: investimet në pasuritë fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore - përpunimi i qumështit, përpunimi i mishit, përpunimi i pemëve dhe perimeve dhe prodhimi i verës; MASA 302: diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve - bletaria, prodhimi dhe promovimi i mjaltit, përpunimi i prodhimeve në fermë, zhvillimi i aktiviteteve artizanale, rritja e shpezëve për vezë dhe për mish; dhe MASA e ujitjes së tokave bujqësore", është thënë tutje në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë.

Në muajt në vijim do të shpallim thirrje të tjera për grante derisa të përfundojë buxheti i planifikuar për periudhën 2020-2021.

Tek Programi i Pagesave Direkte kemi reduktuar një numër të konsiderueshëm të dokumentacionit që kërkohet për aplikim, duke lehtësuar kështu në masë të konsiderueshme kompletimin e dosjes për aplikim e, po ashtu, edhe procedurat e pranimit të aplikacioneve në drejtoritë komunale përgjegjëse për bujqësi.

Risitë e Programit për Pagesat Direkte, pra subvencionet, për vitin 2020 janë: Subvencioni për lopët dhe buallicat qumështore është rritur nga 70 në 85 euro për krerë; Subvencioni për delet dhe dhitë është rritur nga 15 në 20 euro për krerë; Subvencioni për frutat e mjedrës të dorëzuar apo shitur është rritur nga 8 në 12 cent për kilogram; Subvencioni për perimet që kultivohen në ambiente të mbrojtura, pra serra, është rritur nga 300 në 450 euro për hektar për ta përkrahur bujqësinë intensive; Subvencioni për therjet e raportuara të gjedhit në thertore të licencuara me standarde është rritur nga 50 në 75 euro për krerë; Subvencionimi për herë të parë për bimët mjekësore dhe aromatike (BMA), në vlerë prej 450 eurosh për hektar. Ky sektor ka treguar potencial të shkëlqyeshëm për eksport duke ndihmuar në zbutjen e bilancit negativ tregtar të vendit tonë.

"Bazuar në trendët e viteve të kaluara, presim që me këto 53 milionë euro të financojmë rreth 865 projekte të granteve dhe rreth 47 000 subvencionime. Kjo thirrje për aplikim për Programin e Zhvillimit Rural, pra për grante, do të jetë e hapur nga sot më 20 korrik deri më 20 gusht 2020 me rikujtimin që do të ketë edhe thirrje të tjera për grante deri në shfrytëzimin e buxhetit deri në dhjetor të vitit 2021. Thirrja për aplikim për Programin e Pagesave Direkte, pra për subvencione, do të jetë e hapur nga sot më 20 korrik deri më 14 gusht 2020. Ftojmë të gjitha komunat që gjatë kësaj periudhe t'u ofrojnë përkrahje maksimale drejtorive të tyre të bujqësisë në menaxhimin e procesit të pranimit të aplikimit nën protokollin e menaxhimit të Covid-19", theksohet në njoftimin e Ministrisë së Bujqësisë.

# Në Shqipëri importi i peshkut dhe produkteve nënujore ka kaluar shifrën e 1 miliard lekëve

TIRANË, 20 KORRIK - Importi i peshkut dhe produkteve nënujore ka kaluar shifrën e 1 miliard lekëve gjatë muajit qershorit. Kjo është hera e tretë në histori që këto produkte kalojnë nivelin e 1 miliard lekëve importe në muaj. Kështu, të dhënat e qershorit flasin për rreth 1 miliard lekë importe, nga 776 milionë lekë të muajit paraardhës dhe 798 milionë lekë të qershorit të vitit paraardhës.

Në terma vjetorë ,rritja fiksohet në masën 25 për qind. Vetëm dy muaj të tjerë në histori, që prej raportimit të të dhënave të tregtisë së jashtme të detajuara nga Instituti i Statistikave, kjo shifër ka qenë më e lartë; në korrik të 2018-s dhe në qershor të 2017-s, me 1.15 dhe 1.1 miliard lekë respektivisht, shkruan "scantv".

Të dhënat e Instatit flasin gjithashtu për një rënie të ndjeshme të eksportit të këtyre produkteve, në masën 48 për qind në terma vjetorë. Të dhënat përkthehen në një rritje të ndjeshme të kërkesës së brendshme për këto lloj produktesh. Rritja e kërkesës vjen pavarësisht situatës së rëndë që po kalon ekonomia vendëse, konsumi dhe sidomos sektori i turizmit si pasojë e pandemisë globale.



# Në Kamenicë fillon faza e aplikimit për pagesa direkte-subvencione

KAMENICËS, 20 KORRIK (ER) - Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZh) në Kamenicë ka njoftuar të gjithë fermerët se nga e hëna ka filluar faza e aplikimit për pagesa direkte-subvencione për këtë vit.
Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar se i ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që ky proces të përfundojë sa më mirë për fermerët e Kamenicës.
Drejtori i DBPZh-së, Naim Arifi, ka thënë se aplikimi do të kryhet në zyrat e kësaj drejtorie në Kamenicë dhe se do të zgjatet orari për pranimin e aplikacioneve. "Është marrë vendim që nga sot të punohet me orar të zgjatur duke filluar nga ora 08:00 deri në orën 18:00 si dhe do të punohet edhe ditën e shtunë, duke filluar nga ora 08:00 deri në orën 16:00, që t'i pranojmë aplikacionet. Po ashtu, kërkojmë nga fermerët që t'i respektojnë rekomandimet e IKShPK-së, të mbajnë distancë dhe maska që ta ruajmë shëndetin tonë", ka thënë Arifi, duke shtuar se fermerët që nuk janë të pajisur me maska nuk do të pranohen për ta kryer shërbimin e aplikimit. Procesi i aplikimit për subvencione do të zgjasë deri më 8 gusht të këtij viti.



# Latifi vazhdon vendosjen e pllakave përkujtimore në shtëpitë e familjeve patriotike



RAHOVEC, 20 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se të hënën me bashkëluftëtarë, miq dhe familjarë kanë vazhduar zbulimin e pllakave përkujtimore në nderim të "Epopesë së Korrikut 1998". Ai ka treguar se kanë vendosur pllaka përkujtimore në fshatin Zaqisht, konkretisht në shtëpinë e Manush Kabashit, bashkëluftëtarit Jetullah Kabashi dhe në shtëpinë e Haki Shalës.
Po ashtu, ai ka thënë se pllaka të tilla kanë vendosur edhe në Hoçë të Vogël, konkretisht në shtëpinë e Afrim Krasniqit dhe të Hysen Krasniqit-Cena. "Me vendosjen e pllakave përkujtimore institucionalizohen vlerat e UÇK-së. Çdo tentim njollosje ndaj UÇK-së nuk do të zë vend në asnjë gjeneratë. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit tonë që sakrifikuan jetën për atdhe, mirënjohje dhe falënderim për familjet që shtëpitë e tyre i kthyen në baza të UÇK-së! Lavdi përjetë dëshmorëve të kombit! Nderim dhe mirënjohje për luftëtarët e lirisë dhe familjet që i dhanë pa kursim mbështetje UÇK-së!", ka thënë Latifi.

# Situata me Covid-19, Gjilani mbyllë shërbimet për gjeodezi, kadastër dhe pronë



GJILAN, 20 KORRIK (ER) - Me vendim të kryetarit të Komunës së Gjilanit, njëherësh udhëheqës i Komitetit për Parandalimin e Përhapjes së Covid-19, janë mbyllur shërbimet në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë. "Vendimin e kam marrë për të parandaluar përhapjen e Covid-19, derisa shërbimet do të rihapen sapo të krijohen kushtet. Kërkoj mirëkuptimin e qytetarëve", ka thënë kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, në mbledhjen e rregullt online me bordin e drejtorëve.
Në këtë takim është diskutuar edhe për reformën në arsim, për përmbylljen e vitit shkollor, përfshirë edhe organizimin e testit të arritshmërisë dhe të maturës që do të mbahen në muajin gusht, sikurse edhe për fillimin e vitit të ri shkollor.
Kreu i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka konfirmuar se po punohet me kapacitete të limituara në administratën komunale, pasi një pjesë e zyrtarëve janë liruar në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.
Edhe në këtë takim Haziri u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos dalin në vende publike pa maska dhe ta mbajnë distancën fizike.

# Komuna e Ferizajt fillon një mënyrë të re të komunikimit me qytetarë

FERIZAJ, 20 KORRIK (ER) - Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyqi, përmes një konference për media ka bërë me dije se nga e hëna qytetarët ferizajas do të kenë më të lehtë formën e komunikimit dhe për rregullore të ndryshme që do të dalin në diskutim publik. Ajo ka thënë se ka filluar një praktikë e re e komunikimit, ku qytetarët do të kenë qasje në uebfaqen e komunës, ndërsa vërejtjet, sugjerimet dhe komentet e dokumentit mund t'i dërgojnë edhe përmes postës elektronike. "Që nga sot po fillojmë një mënyrë të re të komunikimit me qytetarët për konsulta të ndryshme sa iu përket akteve normative që kalojnë përmes Kuvendit e që duhet diskutuar edhe me qytetarët. Qytetarët do të kenë mundësi që të qasen në uebfaqen e komunës, 'kk.rks-gov.net/Ferizaj' dhe tek rubrika 'shërbime' është një rubrikë e veçantë ku, pasi të klikojnë, do ta kenë mundësi që ta shohin edhe draftin e publikuar dhe pastaj t'i japin komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre rreth atij drafti brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga publikimi i atij drafti", është shprehur Gashi-Bytyqi. Sipas saj, kjo është një formë e re e komunikimit me qytetarë, sepse ka raste të shumta ku mungojnë në diskutimet publike. "Besoj se ky do të jetë një motivim shtesë për qytetarët që t'i drejtohen komunës me kërkesat e tyre pasi e kemi vërejtur vazhdimisht që kemi pasur mungesë të qytetarëve në debatet publike. Edhe pse kemi bërë thirrje gjithmonë që të marrin sa më shumë pjesë në këto diskutime publike, prapë ka pasur mungesë, por kjo që po bëhet është një praktikë që po bëhet për herë të parë në Ferizaj dhe kështu do të vazhdohet që të punohet më tutje", ka thënë Gashi-Bytyqi.



# UÇK-ja ISHTE USHTRI QË LUFTËN E BËRI PARA SYVE TË TË GJITHË BOTËS PËR T'IA DHËNË KOMBIT LIRINË (12)



Shkruan: Kudusi LAMA

Ajo ushtri që mbajti mbi shpatulla atë luftë të lavdishme që përpiqesh të na e njollosësh, nuk ishte ushtri e shfrytëzimit të kufomave. Ajo ishte ushtri që luftën e bëri para syve të të gjithë botës për t'ia dhënë kombit lirinë dhe e realizoi me shumë ndershmëri. Por ju doni t'ia zhvishni lavdinë duke shpikur monstruozitete, duke dhënë goditje të rënda me peshën e opinionit botëror, duke tentuar t'i pastrosh të dashurit e t'u serbë nga krimet që kanë bërë: "... duke viktimizuar atë që ka ushtruar gjenocidin e paparë ndaj një populli të tërë ku ende nuk dihet asgjë dhe askush nuk jep llogari për fatin e mijëra shqiptarëve të zhdukur të Kosovës nga po kjo makineri ushtarake serbe! Duke tentuar që viktima, në këtë rast shqiptarët e Kosovës, në kohën kur ishte në pyetje ekzistenca e tyre fizike në Kosovë dhe mezi arrinin që ta siguronin armatimin e nevojshëm për t'i bërë ballë makinerisë shfrenuese serbe ...", të duket sikur paska qenë ajo një forcë kriminele, që nuk paska menduar gjë tjetër vetëm si të pasurohet, kur realisht unë, duke i njohur djemtë dhe vashat luftëtare të UÇK-së, jam i bindur se në personin e secilit prej tyre nuk ka pasur asgjë tjetër përveç gatishmërisë për ta dhënë jetën në çdo çast përballë makinerisë gjakatare serbe.

Ju vazhdoni të fshiheni pas deklarimit se nuk keni gjë me shqiptarët dhe se nuk keni për qëllim ta njollosni UÇK-në, luftën e saj dhe shqiptarët në tërësi, por vepra juaj flet krejt ndryshe: "... do të duhet shumë punë për të përballuar një strategji të qartë antishqiptare, që së pari synon t'i zhvleftësojë çlirimtarët dhe udhëheqësit e Kosovës, e prej këtej vetë shtetin e ri të Kosovës. Mendoj se duhet thënë më qartë se përpjekjet e Dick Martyt dhe të tjerëve si ai, për t'i 'institucionalizuar' këto akuza në organizma politike ndërkombëtare, synojnë për t'iu imponuar organeve të drejtësisë, në mënyrë që këto të fundit t'i vërtetojnë akuzat e tij(?!). Gjithë këto veprime kanë pamjen e një komploti kundër pavarësisë së Kosovës dhe në analizë të fundit nuk kanë të bëjnë thjesht me akuza ndaj individësh, të cilët, po të mos ishin në udhëheqje të këtij shteti të ri, nuk do të rëndoheshin me to".

Ju zotëri deri tani kryet një detyrë të padenjë për shoqërinë moderne. Ju me veprën tuaj hodhët gurin e rëndë për ta vrarë shtetin e Kosovës. Të jeni i sigurt se edhe gurin tuaj shqiptarët do ta përballojnë, ashtu siç kanë përballuar edhe mjaft gurë të tjerë që u kanë ardhur nëpër histori, që ju si bashkëpunëtor i serbëve dhe megafon e Serbisë e dini mirë. Por shqiptarët dinë se ju ose të tjerë si ju do të vazhdojnë edhe me tej, të tentojnë të hedhin gurë të rëndë mbi ta. Të jesh i sigurt që shqiptarët do ta bëjnë historinë e tyre në interes të tyre, sepse me ta ka qenë, është e do të jetë e drejta dhe e vërteta, ani pse ju ndërtuat një padrejtësi me pamoralësinë tuaj.

Ju me raportin që paraqitet menduat se do ta rrënoni Kosovën; ju bëni akuza duke mos deklaruar asnjë dëshmitar, por nëpërmjet deklarimeve të dëshmitarëve anonimë, që nuk dihet se çfarë janë. Ju keni deklaruar se do t'i gjeni fajtorët, pasi Kosova ta hapë rrugën duke ta miratuar edhe një Gjykatë Speciale për këtë çështje, a do ta arrish atë që ke synuar? Apo synimi yt ka qenë vetëm për të njollosur, pasi ke menduar se shqiptarët nuk do ta kenë guximin ta bëjnë këtë që bënë, ta pranonin pra Gjykatën Speciale që kërkoj Evropa? Shqiptarët dhe në radhë të parë luftëtarët e lirisë, pikërisht ata që akuzoni Ju në raport, e krijuan gjykatën sipas dëshirës suaj, sepse nuk kanë frikë, sepse besojnë në pastërtinë e veprës së tyre, sepse besojnë në drejtësinë juridike. Por ata gabuan vetëm për një shënim të thjeshtë, që pasi të gjykohen e ta marrin pafajësinë luftëtarët e lirisë, kjo gjykatë ta gjykojë e ta dënojë përpiluesin e raportit të rrejshëm dhe ata që kanë kërkuar krijimin e kësaj gjykate, si dhe t'i paguhen Kosovës të gjitha shpenzimet financiare që do të bëjë kjo gjykatë në jetëgjatësinë e saj.

Unë personalisht kam qenë dhe mbetem kundërshtar i këtij veprimi të politikës së Kosovës për miratimin e Gjykatës Speciale për të hetuar sipas deklarimeve të raportit tuaj. Dhe mbetem kundër, se nuk e honeps dot si buzëqesh i kënaqur ti me padronët e tu që të kanë paguar si megafon që të kanë. Kjo botë, zotëri Dick, nuk është vetëm për sensacione të tipit tënd. Kjo është botë moderne, u shkon problemeve deri në fund. Po pas fundit, cili do të jetë morali dhe e drejta në pësonin tënd? Skenari yt më duket se do të ketë fund të turpshëm.

Po pse thonë se: "Dick Marti gjithmonë është dëshmuar si përkrahës i flaktë i Serbisë dhe kundërshtar i hapur dhe i përbetuar i pavarësisë së Kosovës". A është e vërtetë se pikërisht për këtë ju jeni ftuar nga Serbia, për të bërë këtë që bëtë me raportin tuaj të shfrenuar dhe pa asnjë nivel etike intelektuale, profesionale, politike, diplomatike, mediatike dhe qytetare? A është e vërtetë se ju i hytë "... këtij aksioni të porositur e, pse jo, edhe të mirëpaguar nga padroni me një qëllim të caktuar, që përmes inskenimeve profesionale t'i mbillte bëmat e krimit serb në jetën e padjallëzuar të shqiptarëve, të atyre shqiptarëve që presin mysafirin qëllimkeq Dick Martin, si mik me zemër të hapur dhe në mënyrë të sinqertë në shtëpitë e tyre të varfra por bujare, ende pa e ditur se çfarë problemi do të lindë dhe me çfarë fajesh do të ngarkohet kombi shqiptar në tërësi, nga imagjinata e sëmurë e këtij antishqiptari të përbetuar dhe improvizuesi të pakompromis".

Unë jam i sigurt se autori i këtyre radhëve ka plotësisht të drejtë dhe na sqaron për moralin dhe të drejtën që e mbisundon raportin tënd.

Por ju, me thënë të drejtën, jeni treguar mjeshtër i përgatitjes së skenarit të këtyre shpifjeve në raportin tuaj. Megjithëse nuk besoj se jeni lodhur të shkruani, ju mendoj vetëm keni firmosur, se raportin ua kanë përgatitur dhe ua kanë dhënë të gatshëm serbët.

Një ditë në Kosovë dëgjova një tregim tronditës. Tregimi ishte kështu:

"Një qytetar serb, në një takim mes tyre, e pyet një qytetar shqiptar:

- A mundesh ti t'ia presësh kokën djalit tënd dhe ta hedhësh në oborrin tim kokën e tij, që të më akuzosh mua se ta kam vrarë djalin?

- Jo - i thotë shqiptari - një gjë të tillë nuk mund ta bëj, se nuk jam i çmendur.

- E po unë e bëj - i thotë serbi - prandaj më mirë rri larg meje".

Ta tregova këtë episod, o zoti Marty, se realisht e ke ditur apo jo këtë mendësi, unë nuk e di, por ju realisht keni bërë të njëjtën gjë si ai qytetari serb sepse përfaqësuesit e atij janë edhe ata që të paguan për raportin, pasi edhe Ju e hodhët kokën e prerë të djalit në oborrin tonë dhe po na akuzon se ta kemi prerë ne.

Kur kam lexuar si më poshtë, me thënë të drejtën, jam befasuar, pasi nuk kam menduar se mund të arrini deri këtu: "Karakterin e dyshimtë të Dick Martit më së miri na e sqaron Abdulla Katuçi, pronari i shtëpisë së 'Verdhë', i cili hedh akuza të rënda ndaj këtij raportuesi të çuditshëm, kur gjatë vizitës së Dick Martit dy vjet më parë në shtëpinë e tij, po të mos e ndalonte i zoti i shtëpisë, ai tentoi me forcë të hidhte eshtra të vdekurish në brendinë e shtëpisë, për çka pronari i asaj shtëpie të instrumentalizuar për qëllime të tilla meskine, me të drejtë edhe kërkon nga shteti që të ngrehë padi kundër raportuesit të KE-së, Dick Martit, si dhe kundër ish-kryeprokurores së Hagës, Carla del Ponte, për shpifje dhe akuza të pabaza kundër viktimave shqiptare".

Jam edhe i sigurt se shqiptari nuk e akuzon mysafirin. Ai e nderon atë. Vetëm kur e tepron rëndë, siç duket se e keni tepruar Ju në rastin në fjalë, ai reagon, por përsëri me maturi, si ky qytetari shqiptar, që thjesht nuk u ka lënë të bëni çfarë të doni ju në shtëpinë e tij dhe ka kërkuar ndihmën e shtetit. Po vërtet, si nuk ju ka ardhur rëndë ta bëni këtë zoti Marty? Kaq të vështirë qenkan serbët kur të rekrutojnë siç ju kanë rekrutuar Ju dhe ju kanë vënë detyra kaq të vështira? Por prapë mirë e keni, se kur merret një detyrë duhet kryer me çdo mënyrë, siç keni tentuar ta kryeni ju, s'ka rëndësi se kush dëmtohet.

Po ne që nuk të japim dot eshtra njerëzish në thes, si do të bëjmë? Kur do të na tregosh se ku janë eshtrat e të dashurve, të nënave e të baballarëve shqiptarë, të grave, të djemve e të vajzave shqiptare? Të na tregosh, "... për rrethanat, kushtet dhe mënyrën se si u vranë shqiptarët nga Serbia, arsyen e varrosjes dhe zhvarrosjes së disahershme të viktimave shqiptare nga kriminelët serbë, shkakun e bartjes së kufomave nga Kosova në Serbi, qëllimin e kidnapimit të mijëra shqiptarëve, sqarimin çfarë në të vërtetë ndodhi me organet e tyre dhe jetën e shqiptarëve të kidnapuar nga Serbia, pse u zhdukën dhe si humbi çdo gjurmë nga ta, ku mbetën dhe kur do të kthehen, çka ndodhi me ta dhe çfarë u bë me organet njerëzore të viktimave dhe të kidnapuarve shqiptarë, qëllimin dhe shkaqet e veprimeve të tilla, të papara e të padëgjuara në asnjë vend tjetër në botë deri më tani... si u kaluan të gjitha këto në heshtje, kur do të kemi sqarime dhe kush do të japë përgjegjësi për të gjitha këto krime ndaj shqiptarëve, nëse jo Serbia?!" Ne nuk të paguajmë për këto, ne nuk presim nga ti të na gjesh të vërtetën sepse të vërtetën, të drejtën dhe moralin, nuk i njeh. Por ne do t'i gjejmë me kohë të gjitha dhe për të gjitha haku do të shkojë tek i zoti.

Zotëri Marty, ju jeni një tregtar i zoti mostrumesh, pasi kur keni arritur t'i shisni Evropës dhe gjithë opinionit botëror aktet barbare serbe si krime të shqiptarëve, ju mund të bëni edhe shumë lloje tregtish të tjera, Zoti na ruajt, të shpresojmë të mos suleni prapë kundër shqiptarëve, se tani mos po vini e gjeni ndonjë bombë atomike, a mos o Zot ndonjë kombinat të prodhimit të armëve të dëmtimit në masë se ti, po u fute në punë, diçka gjen, pasi t'i lëshon eshtrat në shtëpi po të lanë. **(Vijon)**



# Kisha e ‘Shën Iliut’, e rindërtuar nga Ali Pashë Tepelena



Të paktë janë ata që e njohin kishën e “Shën Iliut” që ndodhet në Bual të Përmetit, e cila përpara shekullit të XVII u përfshi nga flakët dhe dëmet ishin kolosale. Ky Monument Kulture i kategorisë së parë daton që në shekullin XII, ndërtuar në stilin bizantin dhe më pas u rindërtua nga Ali Pashë Tepelena.
Në shekullin XII, kisha i shërbente banorëve të fshatit Bual për kryerjen e riteve fetare. Ajo ishte e ndërtuar me stilin bizantin, me afreske që të magjepsin. Por, në fillim të shekullit XVII, Aleksandër Todhe – studiues i trashëgimisë kulturore në Bashkinë e Përmetit – thotë se ky monument kulture u përfshi nga flakët dhe gjithçka u shkërmoq. Afresket u dëmtuan dhe kisha u bë jofunksionale. Kjo për banorët e asaj kohe ishte një tragjedi e madhe, sepse nuk mund të kryenin ritet fetare, për të cilat ushqenin shpirtin. Në gjendje të mjeruar mbeti për shumë kohë, derisa një ditë erdhi lajmi i mirë për rindërtimin e saj.
Fshati Bual njihet për mjekët popullorë, të njohur ndryshe si xheraj. Është një nga zonat që ka ndihmuar në kurimin e pacienteve në të gjithë Ballkanin, madje fama dhe shërbesat e tyre kanë mbërritur deri në Angli. Në fund të shekullit XVII, djali i Ali Pashë Tepelenës, Veliu, sëmuret nga veshkat. Ai kërkoi ndihmë mjekësore gjithandej për t’u kuruar, por përpjekjet ishin të kota, derisa ai ra në kontakt me një nga mjekët popullorë të Bualit. Kur Veliu u shërua plotësisht, Ali Peshë Tepelena e pyeti xherajn se çfarë donte si shpërblim. Ky i fundit kërkoi që rindërtimin e kishës. Kaq u desh dhe Pashai urdhëroi rindërtimin e objektit fetar.
Sipas Andrea Llukanit, i cili është autori i librit me titull “Arti kishtar në Shqipëri”, objekti është njënefësh dhe ka përmasa 21.15 me 9.95 metra. Kjo kishë përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati. Në vitin 1814 kisha ka pësuar një ristrukturim rrënjësor, ku për të zmadhuar naosin është prishur muri perëndimor. Muratura e ndërtimit të kishës është me gurë shtufi. Në të ka tulla të vëna në mënyrë të rregullt. Apsida është trefaqëshe.
Në anën jugore të saj tullat janë të vendosura zigzag. Mbi portën jugore brenda kishës gjendet ky mbishkrim: “Në vitin 1814 u ndërtua nga themeli ky tempull i gjithnderuar në kohën e kujdestarisë së shumënderuarit, zotit Kristo Tasi, në 1850 u pikturua në kohën kur ishte peshkop i gjithhirshmi, zoti Neofiti dhe kujdestar arkimandrit Agathangjeli dhe në kohën kur ishte famulltar prift Gjergji dhe në kohën e kujdestarisë së vëllezërve Vangjelit e të Ilisë Efthimit. U pikturua me dorën e Zikut, Nikollas dhe Kostandinit, vëllezërve nga eparkia e shenjtit të Vellasë, 1850, janar 31”.
Pikturat murale në kishën e “Shën Iliut” zënë gjithë pjesën e brendshme, faqet anësore, kolonat, harqet etj. Afresket janë pikturuar në dy faza. Gjatë fazës së parë që i përket shekullit XII janë pikturuar faqet veriore dhe perëndimore të kishës, ndërsa gjatë fazës së dytë, që i përket shekullit XVIII është pikturuar pjesa e brendshme e naosit. Afresku më i veçantë në këtë kishë është një burrë i cili ka veshur kostum kombëtar me fustanellë. Në këto afreske dominon ngjyra e kaltër.
Sipas Todhes, këto afreske paraqesin interes për shkak të teknikës së tyre të veçantë. Gjithashtu, ka vlera historike dhe artistike. Sipas tij, afresket janë të dëmtuara dhe kanë nevojë për ndërhyrje. Ministria e Kulturës e ka lënë në harresë, ndonëse është shpallur “Monument Kulture” i kategorisë së parë. Ka kujdestari, por jo studim. Është pak e studiuar nga ekspertët, ndonëse rreth vetes përmban shumë histori. **/TCh/**

# Për kujtimet, vetminë dhe artin

**Edison ÇERAJ**



Vetmia më e trishtë është kur je me ata të cilët nuk janë pjesë e kujtimeve të tua.
Mesa duket, ka një prirje në rritje për t’u ndarë nga ata të cilët janë pjesë e kujtimeve tona, me të cilët kemi ndarë të shkuarën tonë ose një pjesë të madhe të saj.
Ka dy mënyra mbizotëruese ose kryesore se si ndodh ky fenomen: e para lidhet me emigrimin e brendshëm, kurse e dyta ka të bëjë me emigrimin e jashtëm, jashtë atdheut.
Ka edhe një formë tjetër emigrimi që ka të bëjë me turizmin, një fenomen masiv në rritje, ku gjithnjë e më shumë njerëz zgjedhin të jenë vazhdimisht në lëvizje, në një kërkim që në pamje të parë lidhet me dëshirën për të vizituar vende dhe kultura të ndryshme, por që, në thelb, është nevoja ontologjike për pafundësinë, për një përjetësi të papërcaktueshme që gëlon nga përvojat e reja, që na bën të harrojmë e të harrohemi, ngjashëm me përvojën që ndërkallin narkotikë të caktuar; një nevojë e heshtur për një arratisje të zhurmshme nga realiteti.
Nën peshën e një gjysmë miti si “për një jetë më mirë”, numri i atyre që zhvendosen nga vendlindja sa vjen dhe rritet. Bashkë me këtë rritet ajo që njihet si vetmi me njerëz, rrjedhojë e natyrshme e faktit se njerëzit e rinj me të cilët takohemi nuk janë pjesë e kujtimeve tona.
Kur dikush ndan kujtime të caktuara me ne, nuk i ndan me pritshmërinë qe ne t’i bëjmë një analizë kritike ose ndonjë zbërthim psiko-sociologjik, por sepse thjesht nuk bën dot ndryshe, sepse kujtimet janë bërë edhe për t’u ndarë, për të mos harruar cilët jemi; për ta çmuar vazhdimisht shenjtërinë e së shkuarës sonë, e kujtesës, cilado qoftë ajo. Ne jemi e shkuara jonë, sepse të ardhmen nuk e kemi akoma, ndërsa e tashmja na rrëshqet prej duarve si rërë.
Kujtesa është e shenjtë, ngaqë nuk i nënshtrohet gjykimit, ashtu si çdo shenjtëri tjetër që e tejkalon gjykimin.
Kujtimet tona kërkojnë kujtimet e tjetrit, në kuptimin që një kujtim që ne ndajmë mund të “gjykohet” vetëm përmes një kujtimi që presim; sepse kujtimet nuk bëjnë dot pa ndjekur njëri-tjetrin. Ky është komunikimi i qenësishëm, sepse e vendos në qendër të qenurit në (këtë) botë. Ndërsa ajo që nënkuptohet masivisht me komunikim sot e vendos në qendër aktualen (info të ndryshme ose thashetheme), lëkurën e së tashmes, të zhveshur nga kurmi që mbulon.
Vetmia (jo të qenurit vetëm) kurohet dhe mënjanohet vetëm atëherë kur jemi me dikë me të cilin/cilën mund të ndajmë më shumë sesa aktualen, që përbën pjesën më tunduese në trupin e së tashmes.
Pastaj, natyrshëm sa më s’ka, vetmia shfaqet prore, dihet. Por, edhe kujtimet aty janë, me ne, e nuk na mbetet tjetër veçse t’i shkëmbejmë.
Forma më sublime që ka trashëguar njeriu për të përballuar vetminë dhe peshën e kujtimeve është arti. Ndër të tjera, marrëdhënia dhe përvoja me një vepër arti, sidomos me letërsinë, është edhe shkëmbim kujtimesh nga ana e autorit me lexuesin. Veçse është fjala për ajkën e kujtimeve dhe jo për ato kujtime që nënkuptohen në përgjithësi, pavarësisht se çdo kujtim ka rëndësinë e vet.
Kështu që, koha që ne i kushtojmë një vepre arti mbetet një kohë cilësore, ku vetëdija farkëtohet dhe pasurohet për të shfaqur më të mirën tonë; për ta përballuar aktualen duke depërtuar poshtë lëkurës së saj llamburitëse.
Besoj se diçka të kësaj natyre ka për qëllim Borges-i kur shkruan se “detyra e artit është të shndërrojë gjithçka që na ndodh, ta shndërrojë gjithçka në simbol, në muzikë; të shndërrojë gjithçka në diçka që mund të jetojë në kujtesën e njeriut. Kjo është detyra jonë. Nëse nuk e përmbushim, hidhërohemi. Shkrimtari ose artisti e ka detyrën e gëzueshme ta shndërrojë gjithçka në simbole. Këto simbole mund të jenë ngjyra, forma ose tinguj. Për poetin simbolet janë tinguj dhe fjalë, fabula, histori, poezi. Puna e poetit nuk mbaron kurrë. Nuk ka të bëjë hiç me orët e punës. Ti gjithmonë merr diçka nga bota e jashtme. Diçka duhet të shndërrohet dhe, në fund të fundit, ajo do të shndërrohet. Ky zbulim mund të shfaqet kurdo. Poeti nuk pushon asnjëherë. Ai është gjithnjë në veprim e sipër, madje edhe kur ëndërron. Përtej jetës së shkrimtarit ndodhet një vetmitar. Ti mendon se je vetëm dhe, me kalimin e viteve, nëse yjet janë me ty, mund të zbulosh se je qendra e një rrethi të madh miqsh të padukshëm, të cilët të duan, por ti nuk do t’i njohësh kurrë. Dhe, ky është një shpërblim i mrekullueshëm”.
Arti është ngushëllimi më i paanshëm për ta përballuar përkohësinë.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

E rrallë

# Po nuk i pate 250 mijë euro, nuk merr nuse në këtë qytet shqiptar



Dasmat shqiptare kushtojnë shumë, sidomos ata që organizojnë dasma tradicionale. Vetëm veshjet e nuseve në Kërçovë kushtojnë mijëra euro, deri 250 mijë sosh. Për të marrë një vajzë nga Kërçova e Maqedonisë dhëndri i ardhshëm duhet të ketë 5 000 euro për një fustan sipas traditave shqiptare, e po ta shikosh në përgjithësi, atij i duhen 250 mijë për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet që kërkohen nga familja e vajzës. Gjësendet e arit që vendos nusja natën e dasmës, zakonisht kanë çmime nga 1 mijë deri në 5 mijë euro. "Kur kërkojnë nuse në Kërçovë, nëse nuk je i zoti të veshësh në dyly-ma të arit 250 mijë dollarë, atëherë nusen nuk ta japin", është shprehur Elton Mehaj, që ka qenë pjesëmarrës në një dasmë atje.

FOTO E DITES



Pamje mahnitëse nga Shiroka e Shkodrës. / LSA/

## BARSOLETA E DITËS



**Kamerieri dhe uji**

**Mysafiri: Kamerier, a ka ujë?**
**Kamarieri: Po zotëri, sa të duash.**
**Mysafiri: Atëherë ma sill një peshqir se po hyj të lahem.**

KINO ABC PRISHTINE

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**



E jashtëzakonshme

# Bakteri që ha metal

Shkencëtarët në Institutin e Teknologjisë në Kaliforni (Caltech) kanë zbuluar një lloj bakteri që ha metale. Bakteri dyshohet se ekziston prej më shumë se një shekulli, por nuk ishte vërtetuar asnjëherë ekzistenca e tij. Ai është zbuluar aksidentalisht, teksa shkencëtarët po bënin eksperimente me manganin, një mineral që zakonisht gjendet i përzier me hekurin.
Dr. Jared Leadbetter, profesor i mikrobiologjisë mjedisore në Caltech, la një kavanoz me këtë substancë në lavamanin e zyrës së vet. Ai nuk është kthyer në zyrë për disa muaj, pasi punonte jashtë kompleksit, por kur ishte kthyer e kishte gjetur kavanozin me një substancë të zezë, që më vonë e ka zbuluar se ishte mangan i oksiduar. Kjo përbërje ishte formuar nga bakteret. Shkencëtarët kishin zbuluar në të shkuarën se bakteret mund ta oksidonin manganin, por mikrobe që të mund ta nxisnin rritjen ende nuk ishin zbuluar. Eksperti ka shtuar se këto baktere jetojnë në ujërat nëntokësore, që gjenden nën sipërfaqen e tokës, në të çarat në tokë, në rërë dhe gurë. Bakteret mund të heqin ndotësit në ujë nëpërmjet një procesi të njohur si bioremediation, duke zvogëluar sasinë e oksidit të manganit, në të njëjtën mënyrë siç njerëzit marrin frymë, shkruan "The Independent". Tanimë hulumtuesit mund ta kuptojnë më mirë kiminë e këtij fenomeni, që "shërben për furnizimin e mikrobeve të tjera me atë që ata kanë nevojë për të performuar reaksione, që ne i konsiderojmë përfituese dhe të dëshirueshme", shtoi Leadbetter.



**DASHI**
Duhet të jeni shumë i kujdesshëm në dashuri, veçanërisht nëse marrëdhënia juaj ka përjetuar probleme të mëdha.



**DEMI**
Ka ardhur koha për të adresuar çështje të caktuara: përcaktoni marrëdhënien tuaj, flisni për punë ose mendoni për shtëpinë.



**BINJAKËT**
Nëse po ecni paralelisht me dy histori, nëse keni tensione që janë lënë pas dore shumë gjatë, është koha për t'i korrigjuar.



**GAFORRJA**
Do ta ndieni nevojën për të kërkuar bashkëpunime të reja në punë, ose të largoheni pas një bllokade që ka zgjatur për shumë muaj.



**LUANI**
Ju dëshironi më shumë garanci dhe bëni mirë, sepse do të jetë e rëndësishme t'i sqaroni të gjitha marrëdhëniet profesionale deri në muajin nëntor.



**VIRGJËRESHA**
Në këtë periudhë jeni një nga shenjat më të forta dhe më premtuese për çështje praktike dhe të lidhura me punën.



**PESHORJA**
Që nga marsi keni pasur shumë vështirësi dhe dyshime. Ju jeni një nga shenjat e zodiakut që po dilni nga kjo periudhë me kockat gati të thyera.



**AKREPI**
Nëse keni fjalë të rëndësishme për të adresuar, sqarime që do të bëni, është ditë e përshtatshme të përfitoni në 24 orët e ardhshme.



**SHIGJETARI**
Në punë mund të fillojnë projekte të reja të cilat do të mund të realizohen në vjeshtë. Sidoqoftë, në dashuri dikush prej jush po kalon një krizë të vogël.



**BRICJAPI**
Duhet të 'armatoseni' me guxim dhe të flisni qetësisht me partnerin ose me këdo që është afër jush tani.



**UJORI**
Në këtë periudhë keni bërë shumë lëshime, prandaj do të ishte e përshtatshme të filloni të kërkoni për burime të reja.



**PESHQIT**
Në përgjithësi po kaloni një situatë të mirë. Në gusht kjo periudhë do të jetë edhe më mirë! Çiftet që mbijetuan muajt e kaluar, në gusht do ta kenë mbështetjen e yjeve.

# Sophie Turner po numëron ditët e fundit të shtatzënisë




Joe Jonas dhe aktorja Sophie Turner do të bëhen prindër për herë të parë. Në shkurt të këtij viti burime për "JustJared.com" konfirmuan se këngëtari Joe Jonas dhe aktorja Sophie Turner do të bëhen prindër për herë të parë. Lajmi i bukur erdhi vetëm pak muaj pas dasmës së tyre madhështore, mirëpo çifti ka preferuar t'i mbajë gjërat sa më të fshehta. Tashmë aktoren e ndajnë vetëm pak ditë nga ardhja në jetë e foshnjës.

# "Zoti m'u shfaq në Paris", Kanye West habit me deklaratën e pazakontë



Kanye West ka thënë se do ta pranonte nëse e shoqja vendos ta divorcojë për shkak të pretendimeve të tij në tubimin e vet të parë elektoral në Karolinën e Jugut. Gjatë fjalimit të tij të çuditshëm, reperi i njohur ka thënë se ai dhe bashkëshortja Kim Kardashian e kishin diskutuar abortin e vajzës së tyre North, sot 7 vjeçe. West është shprehur se çifti po vuante shumë në vitin 2013 për marrjen e një vendimi për të pasur ose jo një fëmijë, kur Zoti, siç ka theksuar, i është shfaqur atij në Paris. "Unë për pak sa nuk vrava vajzën time", ka thënë reperi përpara turmës së njerëzve të mbledhur për ta dëgjuar. Ai ka theksuar se Kimi kishte pilulën në dorë, kur ekrani i laptopit të tij ishte bërë i zi e pastaj i bardhë. Dhe, sipas tij, Zoti i kishte thënë: "Nëse ti tallesh me vizionin tim, unë tallem me tëndin!"



# Bebe Rexha këshillon të vendoset maska dhe të dezinfektohen duart

Bebe Rexha ka pozuar me maskë në fytyrë dhe duke dezinfektuar duart. Këngëtarja e njohur shqiptare është duke u kujdesuar ta ruajë veten dhe të tjerët ndaj virusit Covid-19. Ajo madje ka këshilluar edhe ndjekësit e saj që t'i vendosin maskat dhe t'i dezinfektojnë duart. "Një foto e imja duke dezinfektuar duart dhe mbajtur maskën", ka shkruar Bebe në njërën fotografi të publikuar në llogarinë e vet në "Instagram", ndërsa në tjetrën ajo u ka thënë ndjekësve "vendosni maskën". Bebe është, po ashtu, një ndër këngëtaret shqiptare me famë botërore e cila nuk e ka harruar asnjëherë prejardhjen. Bebe Rexha vazhdon ta shijojë suksesin në muzikë, ndërsa duke qenë se është shumë e thjeshtë dhe e afërt me njerëzit, ka arritur që rreth vetes të mbledhë një numër të madh të fansave.




# Reperi i famshëm pensionohet nga muzika në moshën 30-vjeçare



Pas një dekade, reperi Logic ka njoftuar se po largohet nga industria e muzikës për t'i kushtuar më shumë kohë familjes së tij. "Njoftoj zyrtarisht pensionimin tim me lansimin e 'No pressure' të prodhuar nga Jo I.D. Albumi lansohet më 24 korrik…", thuhet në një "Tweet" në llogarinë e tij të verifikuar në "Twitter". "Ka qenë një dekadë e shkëlqyeshme. Tani është koha të jesh një baba i shkëlqyeshëm", ishte shprehur ai. Logic është martuar me stilisten Brittney Noell dhe dyshja së fundmi mirëpritën një djalë.




Sport




# Studenti i mjekësisë që asnjëherë nuk e braktisi lojën e futbollit

**Studenti i mjekësisë, Urim Mavraj, krahas suksesit në studime, është duke vazhduar edhe karrierën në futboll. Ai është i përkushtuar që në të ardhmen të bëhet profesionist i mjekisë, pa lënë anash lojën e futbollit. Pavarësisht prej ofertave nga Istogu, Onixi dhe nga disa klube të Kosovës, Urimi ka vendosur të vazhdojë të jetë pjesë e Dardanisë, me synim të inkuadrimit në Ligën e Parë**



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 KORRIK - Urim Mavraj është një futbollist me perspektivë të madhe në futbollin e Kosovës. Përpos futbollist, ai është student i dalluar në Fakultetin e Mjekësisë së Përgjithshme në Tetovë. Loja e futbollit e "rrëmbeu" herët zemrën e djaloshit nga Saradrani i Istogut, i cili në moshën 14-vjeçare e filloi përkushtimin maksimal dhe bëri debutimin në Klubin KF Onix nga Banja. Edhe sot Urimi u është mirënjohës trajnerëve që kanë punuar për zhvillimin e tij të hershëm si futbollist. "Karrierën time futbollistike e fillova në moshën 14-vjeçare në Shkollën e Futbollit KF Onix, gjenerata U15, me trajnerët Gani Metaj dhe Zek Miranaj. Bëja ushtrime individuale edhe me ish-lojtarin e njohur, tash trajnerin Driton Dreshaj. Këta trajnerë më kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Falë këtyre, për një kohë të shkurtër arrita t'i tregoj vlerat në fushën e lojës", ka thënë Urim Mavraj, i cili ka treguar edhe për zhvillimin si futbollist në skuadrën Onixit. "Në atë vit u zgjodha për grumbullimin e ligës rajonale si lojtar i dalluar për grupmoshat U15, më pas vazhdova me grupmoshat U17 të KF Onixit edhe për dy vjet. Ndoshta ishte një ndër sezonet më të mirë që kemi arritur me klub pasi, përveç në ligën rajonale, u shpallëm edhe kampionë në turneun e organizuar në Durrës. Ishte një ndër çastet më të mira dhe të lumtura për mua dhe për bashkëlojtarët. Edhe pse kishte ekipe të forta konkurruese, arritëm ta japim më të mirën. Duke pasur parasysh akademinë e fortë dhe të talentuar, u futëm përbrenda atij viti edhe si ekip senior në Ligën e Dytë dhe, po ashtu, brenda vitit u shpallëm kampionë dhe kaluam në Ligën e Parë", ka treguar Urim Mavraj.



Pas sukseseve me skuadrën e Onixit, Urim Mavraj kërkoi një aventurë të re dhe zgjodhi që karrierën ta vazhdojë në skuadrën e Beharit në Ligën e Dytë. "Erdhi koha që të ndërroja ambient në moshën 17-vjeçare, duke kaluar për një vit te KF Behari në Ligën e Dytë, për gjetjen e hapësirës më të madhe për minuta lojë dhe duke arritur që të bëhem edhe një lojtar vendimtar i klubit i përgatitur dhe me përvojën që më ishte nevojitur. Falënderim dhe mirënjohje pa masë kam për trajnerin e njohur Miftar Rama që më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë", ka shtuar Mavraj, i cili më pas ka vendosur t'i vazhdojë studimet në Tetovë, përkatësisht në Fakultetin e Mjekësisë së Përgjithshme. Por, pavarësisht karrierës në mjekësi, Urimi nuk e tradhtoi lojën e zemrës, futbollin. 21-vjeçari ishte pjesë e Shkëndijës së Tetovës e më pas vendosi që karrierën ta vazhdojë në skuadrën e Dardanisë. "Duke pasur parasysh perspektivën jo të mirë për të depërtuar jashtë vendit, erdhi koha ta vazhdoja një nga ëndrrat që e doja si profesion. Përveç futbollit, doja t'i vazhdoja studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Tetovë. Fillimisht e kisha të vështirë ndërrimin e ambientit, por pas tre muajsh arrita të bëhem pjesë e juniorëve të Shkëndijës, me të cilët jam stërvitur rregullisht dhe në debutimin në një ndeshje miqësore kam shënuar gol. Pastaj pata interesim nga klubet e Kosovës dhe oferta më e përshtatshme ishte nga FC Dardania, e cila më ka mundësuar që stërvitjet t'i mbaj në Tetovë, kurse lojërat e fundjavës t'i zhvilloj në Kosovë. S'dua ta anashkaloj, në këtë rast, korrektësinë nga trajneri Xhavit Nikqi dhe harmoninë që kemi përbrenda klubit", ka deklaruar ai.

Urim Mavraj me skuadrën e Dardanisë synon të inkuadrohet në Ligën e Parë të Kosovës. Ai është pjesë edhe e Klubit të Futsallit Shkëndija, me trajner Tushi Dervishi. Mavraj ka folur edhe për jetën si student dhe futbollist. Ai është i përkushtuar t'i vazhdojë studimet me ritëm të njëjtë dhe të bëhet profesionist në fushën e mjekësisë dhe të kontribuojë për vendin. Po ashtu, ka premtuar se asnjëherë nuk do ta braktisë futbollin. "Edhe pse mund të duket e vështirë që të ndaj kohë për dy profesionet, pasi dihet se mjekësia e përgjithshme kërkon përkushtim të madh, prapëseprapë po arrij të ndaj një pjesë të kohës për stërvitje individuale me trajnerin Rahim Memeti, i cili është punëtor i madh. Tash si një 21-vjeçar, të ardhmen e shoh si një profesionist në lëmin e mjekësisë, duke realizuar një nga ëndrrat e mia që gjithmonë dëshiroja, por duke mos lënë anash edhe pasionin për sportin", ka përfunduar ai.

Për fund, Urim Mavraj ka falënderuar familjen dhe shoqërinë për përkrahjen e vazhdueshme që i kanë dhënë për të arritur deri këtu. Urimi është një model i mirë për të rinjtë që, krahas shkollimit, merret edhe me sport.

## Sot përballen Drita dhe Drenica



PRISHTINË, 20 KORRIK - Java e 32-të e IPKO Superligës së Kosovës në futboll do të fillojë sot (e martë) me ndeshjen në mes të Dritës dhe Drenicës. Kjo ndeshje do të jetë shumë interesante pasi klubi gjilanas është duke kërkuar titullin e kampionit dhe kërkon tri pikë nga kjo përballje, derisa edhe Drenica është në garë për mbijetesë dhe kërkon rezultat pozitiv. Drita është e para në tabelë me një pikë më shumë se Gjilani që zë vendin e dytë, kurse Drenica është e teta me 41 pikë. Ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje zhvillohen nesër (e mërkurë) dhe do të takohen: Gjilani - Ballkani, Prishtina - Flamurtari, Feronikeli - Trepça '89, Llapi - Ferizaj dhe Dukagjini - Vushtrria.

# Stublla: Vendim i duhur i FBK-së, motiv për gjeneratat e reja

PRISHTINË, 20 KORRIK - Vendimi i Bordit i Federatës së Basketbollit të Kosovës për formimin e Përfaqësueses A te femrat dhe pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare po mirëpritet nga komuniteti i basketbollit. Shumë lojtare e kanë ëndërruar një ditë të tillë, megjithatë nuk kishin mundësi të luanin për Kosovën. Ky është një motiv për gjeneratat e reja që do ta kenë mundësi ta shkruajnë historinë për të debutuar me Kosovën në garat ndërkombëtare.




Një nga basketbollistet e gjeneratës së artë është Shemsije Stublla. Ajo ka thënë se ky vendim është shumë i mirë për ata që e duan basketbollin dhe motiv për vashat e reja. "Me siguri se ky duhet të jetë një vendim shumë i mirë dhe i mirëpritur nga të gjithë ata që e duan basketbollin. Posaçërisht mendoj se duhet të jetë një motiv i madh për të gjitha vajzat kosovare që merren me këtë sport. Gjithashtu, është motiv për klubet, trajnerët dhe ata që janë duke punuar për ngritjen e nivelit të basketbollit të femrave në Kosovë. Unë shpresoj që vajzat tona të paraqiten sa më mirë në këto gara dhe ju uroj shumë suksese", është shprehur Stublla për faqen zyrtare të FBK-së.

Duhet theksuar se Shesmije Stublla ka luajtur për Universitetin e Prishtinës deri në vitin 1989 për t'u transferuar më pas në Maribor. Ajo ka qenë lojtare aktive deri në vitin 2000, ndërsa tani jeton dhe vepron në Slloveni. Kosova pritet të marrë pjesë në FIBA Kampionatin Evropian të Shteteve të Vogla, që do të organizohet në vitin e ardhshëm në Nicosia të Qipros prej 15 deri më 20 qershor.

Në FIBA Kampionatin Evropian për Shtetet e Vogla-Femrat në vitin 2020 janë paraqitur për të garuar: Andorra, Qipro, Gjibraltari, Irlanda, Luksemburgu, Malta dhe Norvegjia, por që u anulua për shkak të pandemisë Covid-19. Regjistrimi i shteteve për pjesëmarrje në FIBA Kampionate Evropiane në FIBA Evropë do të bëhet si zakonisht, pra ndërmjet muajve shtator/tetor 2020. FIBA Evropa ka kërkuar nga të gjitha federatat nacionale që t'i regjistrojnë ekipet e tyre për vitin 2021, pasi regjistrimet e paraqitura për vitin 2020 nuk do të merren parasysh.

# 'Topi i Artë' nuk ndahet këtë vit

PARIS, 20 KORRIK - Nuk do të ketë fitues të "Topit të Artë" në vitin 2020 për shkak të gjendjes së shkaktuar në futboll nga pandemia koronavirus. Revista prestigjioze franceze "France Football", e cila e ndan këtë çmim, ka njoftuar se nuk do ta ndajë këtë çmim për këtë vit sepse nuk ka pasur kushte mjaftueshëm të drejta për të vendosur se kush e meriton atë. Messi dhe Ronaldo pritej të ishin sërish në garë për këtë çmim këtë vit, por me konkurrencë të fortë nga Robert Lewandowski i Bayern Munichit dhe Kevin de Bruyne i Manchester City. "France Football" ka shkruar në



uebsajtin e vet: "Në rrethana të jashtëzakonshme, në kushte të jashtëzakonshme. Për herë të parë në historinë e vet, e cila nisi më 1956, 'Topi i Artë' nuk do të ndahet në vitin 2020 për shkak të mungesës së kushteve mjaftueshme të drejta".

## 3 futbollistë infektohen me koronavirus te Lille

Covid-19 vazhdon të jetë i pranishëm në botën e futbollit, teksa së fundmi te skuadra e Lilles janë shënuar tri raste. Përgjigjet e testeve të kryera kanë konfirmuar infektimin e Renato Sanchos (kampion Evrope me Portugalinë në vitin 2016), Jonathan Ikone (mesfushori ofensiv) dhe Jonathan Bamba (sulmuesi i majtë). Tre futbollistët janë prekur nga data 6 deri në 13 korrik, ndërsa ndodhen të izoluar në shtëpitë e veta. Lille e mbylli në vend të katërt sezonin duke mos arritur dot në zonën Champions.

## SHKURT

### Cazorla transferohet në Al Sadd

Santi Cazorla të dielën e ka luajtur ndeshjen e fundit me fanellën e Villarrealit, duke i dhënë fund një aventure të shkëlqyer. Pas kësaj ndeshje, mesfushori spanjoll tashmë ka njoftuar edhe për hapin e tij të ardhshëm në karrierë. Skuadra e Al Sadd ka njoftuar se Cazorla i është bashkuar sot skuadrës, duke zyrtarizuar transferimin. Kujtojmë se Al Sadd drejtohet nga ish-shoku i skuadrës së Cazorla te Spanja, Xavi Hernandez.

### Sancho në United, mungon vetëm zyrtarizimi

Jadon Sancho është shumë pranë largimit nga Gjermania. Sipas "The Sun", lojtari anglez dhe Manchester Unitedi kanë arritur një marrëveshje midis tyre dhe pritet vetëm aprovimi i Borussia Dortmundit. "Djajtë e kuq" janë gati të paguajnë 110 milionë euro për t'i marrë shërbimet e 19-vjeçarit, edhe pse Borussia ka kërkuar 130 milionë. Klubi anglez pritet të fusë në marrëveshje edhe një lojtar, emri i të cilit nuk bëhet me dije nga mediat. "Bild" shkruan se lajmet që qarkullojnë në mediat angleze janë të vërteta dhe se Sancho mund të jetë i Unitedit në sezonin e ardhshëm duke u thënë lamtumirë verdhezinjve pas dy sezoneve në Gjermani.

### Dortmundi zyrtarizon transferimin e Bellinghaminit

Borussia Dortmund e ka zyrtarizuar transferimin e talentit 17-vjeçar anglez Jude Bellingham nga Birmingham City. Bellingham do ta mbajë fanellën me numër 22. Ai do t'i bashkohet Dortmundit në stërvitje nga 30 korriku. Raportohet se Dortmundi ka paguar rreth 23 milionë euro për Bellinghamin, shifër që mund të rritet deri 35 milionë.

### Basaksehiri kampion për herë të parë, akuzohet se u ndihmua nga politika

Basaksehiri shpallet për herë të parë kampion i Turqisë. Në javën e parafundit të Superligës së Turqisë, në derbin e kryeqytetit turk, Basaksehiri mposhti 1-0 Kayserisporin falë golit të Tekdemir (Visca humbi 11-metërsh), duke siguruar matematikisht trofeun një javë para fundit. Diferenca me Trabzonsporin e vendit të dytë është thelluar në 7 pikë, pasi skuadra ku luan ish-sulmuesi i Partizanit, Caleb Ekuban, u mposht 3-4 nga Konyaspori. Basaksehiri me këtë trofe bëhet klubi i katërt i madh i Stambollit, duke iu bashkuar Galatasarayt, Fenerbahces dhe Besiktasit. Gjithsesi, në Turqi ka polemika për ngritjen deri në fron të këtij klubi, që akuzohet për lidhje të forta me politikën. E mbyll me zhgënjim Fenerbahce, që me humbjen 2-0 në derbi përballë Besiktasit (Muriqi la skuadrën me 10 lojtarë që në pjesën e parë) mbetet jashtë zonës evropiane.

### Donnarumma: Ibra solli forcën që na mungonte

Gigio Donnarumma ka thur elozhe për Zlatan Ibrahimoviqin dhe trajnerin Stefano Pioli teksa ka zbuluar edhe objektivat e tij të mëdha. "Ibra është një bishë, një fenomen që na ka dhënë shumë. Prania e tij ndihet shumë dhe ka sjellë atë forcë që na mungonte. Zlatan jep gjithçka në stërvitje dhe arrin të krijojë një mentalitet fituesi në ekip. Është fantastik, nuk do të humbasë kurrë as në stërvitje dhe të jep një mentalitet të jashtëzakonshëm. Forma e mirë e Milanit? Kishim një dëshirë të madhe për t'u rikthyer në fushë dhe për t'i rikuperuar pikët që kishim humbur. Unë ëndërroj të bëhesha portieri më i mirë në botë dhe të fitoja sa më shumë trofe. Dua të fitoj një Botëror me Italinë. Kemi formuar një grup shumë të mirë në kombëtare. Mëkat që Evropiani u shty", ka thënë Donnarumma. "Pioli? E falënderoj shumë trajnerin për fjalët e mira që thotë për mua. Jap gjithmonë maksimumin për të, sepse është një trajner i madh dhe njeri i tillë. Jam i lumtur me atë që po bëjmë në këtë periudhë", ka deklaruar portieri i talentuar, Donnarumma.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.225/2020

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,** departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Naim Meholli në çështjen juridike të paditësit: Qendrim Latifi nga fsh.Shipol-Mitrovicë me vendbanim ne Gjermani, të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. Nexhat Beqiri nga Vushtrria kundër të paditurës: Zelfije Krasniqi nga fsh.Shipol-Mitrovicë tani me vendbanim të panjohur, gjykata me datën: 10.07.2020 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

A K T V E N D I M

**I. Caktohet Av. Sheremet Ademi** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurës: Zelfije Krasniqi nga Fsh.Shipol-Mitrovicë tani me vendbanim të panjohur.

**II.** Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

**III.** Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe te botohet në njërën nga gazetat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

**IV.** Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm bien në barrë palës paditëse.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**
**C.nr.225/2020 me datë 10.07.2020**

**GJ Y Q T A R I,**
**Naim Meholli**

**UDHËZIM JURIDIK** – Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.




## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Mitat Berisha shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 810162264 / Frizer "Mitte"

▶ "V.I.P Relax Center" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810096645

▶ "Led Group Marketing & Consulting" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810830928.

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "IP-KOS" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e derivateve të naftës në Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11. 08. 2020 në ora 11:00 në hapësirat e lokalit "Espresso" rruga "Ukë Bytyqi", Prizren do të organizohet debat publik nga kompania "IP-KOS" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e derivateve të naftës në Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM :
https://us04web.zoom.us/j/73924594720?pwd=RVUwUXRDNUsrNWl4QXdZd1hOV2hRZz09

Meeting ID: 739 2459 4720
Passcode: 3HKG7a
Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit***
***Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine***
***Ministry of Economy and Environment***

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë**

**për Kushtet Ndërtimore**

**"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **"Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".**

Nr. prot: 1461/20 të datës 12.02.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomande:**
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:
http://mmph-rks.org/
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "IP-KOS" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e derivateve te naftës në Suhareke.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11. 08. 2020 në ora 09:30 në hapësirat e lokalit "Infinit" rruga: Brigada 123, Suhareke do të organizohet debat publik nga kompania "IP-KOS" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e derivateve te naftës në Suhareke.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
https://us04web.zoom.us/j/73924594720?pwd=RVUwUXRDNUsrNWl4QXdZd1hOV2hRZz09

Meeting ID: 739 2459 4720
Passcode: 3HKG7a
Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "IP-KOS" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e derivateve të naftës në Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11. 08. 2020 në ora 11:30 në hapësirat e lokalit "Espresso" rruga "Ukë Bytyqi", Prizren do të organizohet debat publik nga kompania "IP-KOS" Sh.p.k Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e derivateve të naftës në Prizren.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:
https://us04web.zoom.us/j/73924594720?pwd=RVUwUXRDNUsrNWl4QXdZd1hOV2hRZz09

Meeting ID: 739 2459 4720
Passcode: 3HKG7a
Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
***Ministria e Punëve të Brendshme***
***Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs***

# K O N K U R S

Në bazë të Nenit 14 të LIGJI Nr. 05/L – 085 për Energjinë Elektrike, Ministria e Punëve të Brendshme shpall konkurs për këtë vend pune:

**Titulli i vendit të punës:**

Drejtor të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

për **përfaqësues nga radhët e komuniteteve jo shumicë**

**KUALIFIKIMI DHE PËRSHTATSHMËRIA PROFESIONALE**
Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Qendrore duhet të ketë kualifikime dhe përvojë pune sipas nenit 17 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087, dhe Neni 9 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si vijon:

- Të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara:
    - në administrim të biznesit;
    - financa të korporatave;
    - financa publike ;
    - menaxhim thesari;
    - banka;
    - biznes konsultimesh;
    - industri ose
    - të ketë qenë së paku për 5 vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Në rast të numrit të lartë të aplikacioneve, kriteret e mëposhtme të dëshirueshme do të përdoren për të vlerësuar aplikacionet, me ç 'rast kandidatët e pasuksesshëm do të eliminohen në fazën e shqyrtimit të CV-ve në procesin e rekrutimit:
Diplomë Bachelor
Diplomë Master,
Kualifikimi profesional pas –diplomimit,
Anëtarë i një shoqate profesionistësh të pranuar në nivel kombëtar
Përvoja e punës ne institucione/projekte ndërkombëtare,
Përvoja e punës në pozitë drejtori ekzekutiv,
Aftësia për të folur dhe të shkruar rrjedhshëm një gjuhë të huaj.

**KUSHTET**
**Një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:**

- Ka qenë i dënuar dhe është nën hetime nga një gjykatë kompetente;
- Ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave;
- Nuk ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim;
- Ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit.
- Nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrjet Publike ku kandidati aplikon.

**Kandidati nuk mund të zgjidhet drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore, nëse:**
- Aktualisht është zyrtar, menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse, *(në kuptim të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike)*, ose cilësdo nga filialet e saj;
- Ka shërbyer si zyrtar ose menaxher i Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj brenda pesë (5) vjetëve të kaluara;
- Aktualisht ka, ose gjatë tre vjetëve të kaluara ka pasur, çfarëdo marrëdhënie materiale afariste *(përveç si konsumator individual i shërbimeve të Ndërmarrjeve Publike)* me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
- Është aksionar, drejtor ose zyrtar në një shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i cili ka marrëdhënie materiale afariste me Ndërmarrjen Publike përkatëse ose cilëndo nga filialet e saj;
- Pranon, ose ka pranuar brenda tre (3) vjetëve të kaluara, kompensim shtesë nga Ndërmarrja Publike përkatëse ose cilado nga filialet e saj *(përveç honorarit të Drejtorit ose kompensimit stimulues të përcaktuar në nenin 20.1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike)*, ose është anëtar në skemën pensionale të Ndërmarrjes Publike përkatëse ose cilësdo nga filialet e saj;
- Përfaqëson një aksionar i cili posedon mbi dhjetë për qind (10%) të aksioneve votuese në Ndërmarrjen Publike përkatëse;
- Ka shërbyer në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike përkatëse më shumë se nëntë (9) vjet nga data e zgjedhjes së parë të tij/saj;
- Është i afërm i shkallës së tretë *(siç është konstatuar në përputhje me përkufizimin e "Interesit Financiar" në nenin 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike)* i cilitdo person që i takon cilësdo nga kategoritë e sipërpërmendura.
- Është zyrtar, drejtor ose aksionar, ose ka një interes financiar në një shoqëri tregtare që konkurron me Ndërmarrjen, ose është menaxher i lartë, zyrtar, drejtor ose aksionar *(i cili posedon më shumë se dy për qind (2%) të drejtave të votimit)*, ose ka një interes të konsiderueshëm financiar në cilëndo nga shoqëritë tregtare që konkurrojnë me Ndërmarrjen;
- Është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 mujore para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;
- Ka çfarëdo konflikti të interesave që për nga natyra, do të shkaktonte që ky person të mos jetë në gjendje që në mënyrë rutinore, me besnikëri, në mënyrë të pavarur dhe objektive t'i përmbushë detyrat e tij financiare ndaj Aksionarëve dhe Ndërmarrjeve Publike.

AFTESITE PERSONALE TE KËRKUARA

- Udhëheqje
- Pune ekipore
- Përdorimi i internetit
- Të menduarit strategjik
- I/e orientuar ndaj rezultateve
- Vendim-marrja
- Aftësi ndikuese
- Koherencë të qartë, komunikim konciz
- Integritet
- Vetëdije
- Të menduarit kreativ

KOHËZGJATJA E MANDATIT:
Mandati i secilit anëtar të Bordit është katër (4) vjeçar, me mundësi emërimi edhe për një mandat tjetër në vazhdim. Mandati i secilit anëtar të Bordit fillon nga data e emërimit nga Kuvendi i Republikës se Kosovës.

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT**

Kandidatët për drejtorë në Bordin e Ndërmarrjes Publike duhet të dorëzojnë këto dokumente (Dështimi për ta bërë këtë do të rezultojë në refuzimin e aplikacionit):

- CV-në e cila ofron shembuj të arritjeve në punë
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim (formular, i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën (dëshminë) që dëshmon se nuk është nën hetime
- Shtetas i Kosovës (kopje të pasaportës ose të letërnjoftimit).

Aplikuesi duhet të plotësoj personalisht deklaratën nën betim me rastin e aplikimit, në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale. Çdo përgënjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë në diskualifikimin e menjëhershëm.

Dokumentacioni duhet të jetë në pliko (zarf) të mbyllur ku shkruhet emri dhe mbiemri si dhe emri i Ndërmarrjes Publike në të cilën konkurron kandidati dhe të dorëzohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Zyra e Personelit, zyra nr. 320, kati III , ndërtesa e Pallatit të Shtypit, Prishtinë, ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: http://map.rks-gov.net
Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Origjinalet kërkohen gjatë intervistës.

Për informata shtesë mund të njoftoheni përmes telefonit 038/ 200 30 185.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

Kompensimi i anëtarëve të Bordit, përcaktohen nga Kuvendi deri në nxjerrjen e Ligjit përkatës për pagat e funksionarëve të lartë publik. .

Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit.




RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
***Ministria e Punëve të Brendshme***
***Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs***

## K O N K U R S

Na osnovu člana 14. Zakona br. 05/L – 085 o električnoj energiji, Ministarstvo Unutrašnjih Poslova objavljuje konkurs za ovo radno mesto:

**Naziv radnog mesta:**
Direktor odbora operatera prenosnog sistema.
Za predstavnik iz ne-većinskih zajednica

**KVALIFIKACIJE I PROFESIONALNA PODOBNOST**
Da bi jedan kandidat bio izabran za direktora Odbora u Centralnom javnom preduzeću, mora imati kvalifikacije i radno iskustvo u skladu sa članom 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, i člana 9. Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, i to:

- Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva na visokom nivou upravljanja u sledećim oblastima:
  - u poslovnoj administraciji;
  - korporativnim finansijama;
  - javnim finansijama;
  - upravljanje trezorom;
  - banke;
  - poslovnim konsultacijama;
  - industriji ili
  - da je radio najmanje 5 godina kao ovlašćeni računovođa, kvalifikovani pravnik, ili kvalifikovani član bilo koje druge profesije koja je povezana za poslovnu delatnost Centralnih javnih preduzeća.

U slučaju velikog broja aplikacija, sledeći poželjni kriterijumi biće korišćeni za procenu aplikacija, pri čemu neuspešni kandidati biće eliminisani u fazi razmatranja biografija u procesu regrutovanja:
Diploma osnovnih studija
Diploma master studija,
Postdiplomske profesionalne kvalifikacije,
Član nacionalno priznatog profesionalnog udruženja
Radno iskustvo u međunarodnim institucijama/projektima,
Radno iskustvo na položaju izvršnog direktora,
Sposobnost da tečno govori i piše jedan strani jezik.

**USLOVI**
**Osoba nema pravo vršenja funkcije direktora u Odboru centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:**

- Bio osuđen ili je pod istragom nadležnog suda;
- Prekršio etički kodeks ili standarde profesionalnog ponašanja, osim ako je ta kazna preinačena od strane suda ili drugog žalbenog organa;
- Lažno svedočio pod zakletvom;
- Bio na rukovodećoj funkciji u kompaniji koja je bankrotirala tokom poslednjih deset (10) godina.
- Ne radi u bilo kojoj instituciji koja kreira razvojne politike za Javna preduzeća kod kojih kandidat aplicira.

**Kandidat ne može biti izabran za direktora Odbora centralnog javnog preduzeća, ukoliko je:**
- Trenutno je službenik, menadžer dotičnog Javnog preduzeća, *(u smislu člana 21. Zakona o javnim preduzećima)*, ili bilo koje od njenih filijala;
- Služio kao službenik ili menadžer dotičnog Javnog preduzeća, ili bilo koje od njenih filijala, tokom proteklih pet (5) godina;
- Trenutno, ili tokom proteklih tri godina, se nalazi u bilo kakvim materijalnim poslovnim odnosima *(osim kao individualni korisnik usluga Javnih preduzeća)* sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala, bilo da je to direktno ili indirektno;
- Akcionar, direktor ili službenik u privrednom društvu ili drugom pravnom licu, koji ima materijalne poslovne odnose sa dotičnim Javnim preduzećem ili bilo kojom od njenih filijala;
- Prima, ili je primao tokom prethodne tri (3) godine, dodatnu kompenzaciju od dotičnog Javnog preduzeća ili od bilo koje od njenih filijala *(osim honorara za direktora ili stimulativne kompenzacije utvrđene članom 20.1 Zakona o javnim preduzećima)*, ili je član penzione šeme dotičnog javnog preduzeća ili bilo koje njene filijale;
- Predstavlja akcionara koji poseduje više od deset odsto (10%) akcija sa pravom glasa u dotičnom Javnom preduzeću;
- Služio u Odboru direktora dotičnog Javnog preduzeća više od devet (9) godina od datuma njegovog/njenog prvog izbora;
- Rođak u trećem kolenu *(kao što je utvrđeno u skladu sa definicijom "Finansijskog interesa" u članu 2. Zakona o javnim preduzećima)* bilo koje osobe koja pripada nekoj od gore navedenih kategorija.
- Službenik, direktor ili akcionar, ili ima finansijski interes u privrednom društvu koje konkuriše sa Preduzećem, ili je viši menadžer, službenik, direktor ili akcionar *(koji poseduje više od dva odsto (2%) prava glasa)*, ili ima značajan finansijski interes u bilo kom od privrednih društva koje konkurišu sa Preduzećem;
- Trenutno, ili u bilo kom trenutku tokom perioda od 36 meseci pre datuma apliciranja, bio je javno izabrani zvaničnik, politički imenovan ili nosilac rukovodeće funkcije ili donosilac odluka u političkoj stranci;
- Ima bilo kakav sukob interesa koji bi po prirodi prouzrokovao da ova osoba ne bude u stanju da rutinski, pouzdano, nezavisno i objektivno ispunjava svoje finansijske obaveze prema akcionarima i javnim preduzećima.

POTREBNE LIČNE SPOSOBNOSTI

- Liderstvo
- Timski rad
- Korišćenje interneta
- Strateško razmišljanje
- Orijentisanje na rezultate
- Odlučivanje
- Uticajne sposobnosti
- Jasnu koherentnost, koncizna komunikacija
- Integritet
- Svest
- Kreativno razmišljanje

TRAJANJE MANDATA:
Mandat svakom članu Odbora traje četiri (4) godine, uz mogućnost imenovanja na još jedan mandat. Mandat svakom članu Odbora počinje od dana imenovanja od strane Skupštine Republike Kosovo.

**OPŠTE INFORMACIJE ZA KANDIDATE O PROCEDURAMA ZA KONKURISANJE**

Kandidati za direktore u Odboru javnog preduzeća moraju dostaviti sledeća dokumenta (Neuspeh dostavljanja sledećih dokumenata rezultiraće odbacivanjem aplikacije):

- Biografija u kojoj su navedeni primeri uspeha u radu
- Motivaciono pismo
- Izjavu pod zakletvom (obrazac koji se popunjava u trenutku podnošenja dokumentacije)
- Dokumentacija predviđena prema uslovima za zapošljavanje (potvrde o profesionalnoj kvalifikaciji, radnom iskustvu)
- Sertifikat (potvrdu) koji dokazuje da nije pod istragom
- Državljanin Kosova (kopiju pasoša ili lične karte).

Podnosilac aplikacije mora lično popuniti izjavu pod zakletvom prilikom apliciranja, u kojoj izjavljuje da on/ona ispunjava uslove kvalifikacije, nezavisnosti i profesionalne podobnosti. Svako materijalno lažno predstavljanje, bilo da je to namerno ili nenamerno, ili materijalna promena od datih informacija u gore navedenoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Dokumentacija treba da bude dostavljena u zapečaćenoj koverti na kojoj treba napisati ime i prezime kao i naziv Javnog preduzeća u kojoj kandidat konkuriše i dostaviti Ministarstvo Unutrašnjih Poslova, kadrovskoj službi, kancelarija br. 320, sprat III, zgrada Palate štampe, Priština, ili putem elektronske pošte na linku: http://map.rks-gov.net
Dostavljena dokumentacija se ne vraća. Originali su potrebni tokom intervjua.

Za dodatne informacije pozovite na broj telefona 038/ 200 30 185.

Biće kontaktirani samo kandidati koji su izabrani za intervju.

Iznos za naknadu članova Odbora utvrđuje Skupština do donošenja odgovarajućeg Zakona o platama visokih javnih funkcionera.

Konkurs je otvoren 30 dana od dana objavljivanja

